

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 193, Nëntor 2019


Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

PËRURORHET KISHA 800 VJEÇARE NË BALLDRE

4

Sikur edhe Zoti ishte me ne sot në Balldre të Lezhës. Koha ishte e shkëlqyer. Shirat qëllimisht e kishin ndal turrin. Ngjasonte si një ditë pranvere, e jo vjeshtë siç është sot, me 16 nëntor 2019. Bukurinë kësaj feste ja shtuan me dhjetëra e dhjetëra banor të ardhur, jo vetëm nga Balldreni e Lezha. Por edhe nga Shkodra, Tirana e të tjerë. Përrurimi i kësaj Kise ishte organizuar nga Dioqeza e Lezhës, Instituti Arkeologjik, Konsullata e Nderit e Austrisë dhe Bashkia e Lezhës.

Në këtë përrurim morën pjesë shumë personalitete lokale, qendrore dhe nga jashtë Shqipërisë. Në mesin e të cilëve do të veçoja: Ministrin e Brendshëm z. Sander Lleshaj, Kryetari i Bashkisë të Lezhës z. Pjerin Ndreu, Prefekti i Qarkut z. Gjok Jaku, Kryetari i Këshillit Qarkut z. Eduart Ndreca, Ambasadori i Kosovës, në Shqipëri z. Sylë Ukshini, Nunci Apostolik në Shqipëri, Mons. Charles John Broës, Konsullin e Nderit të Austrisë, z. Gjergj Leqejza, Ipeshkvi i Lezhës Mons. Ottavio Vitale. Të ftuar ishin nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Kryetari dhe N/Kryetari i Shoqatës, z. Ndue Sanaj e Agron Hasanaj.



TEATRI "MIGJENI" KUJTESA E NJË KOMBI

KREMTOHET ME MADHËSHTI E NDERIME 70 VJETORI I FORMIMIT TË TRUPËS PROFESIONISTE TË TEATRIT "MIGJENI" NË SHKODËR

2

Po e filloj këtë shkrim me këtë përcaktim, duke perifrastuar titullin e librit "Teatri "Migjeni"-kujtesa e një qyteti" të shkrimtarit e studiuesit shkodran Xhahid Bushati. Po e filloj këtë shkrim pikërisht me daljen në dritë të këtij libri brilant që padyshim është një pjesë e rëndësishme në enciklopedinë e kulturës dhe artit shqiptar. Autori i këtij libri dokumentar, profesori i letërsisë Xhahid Bushati që në rininë e tij studentore përkrah pedagogëve të tij të nderuar, shkrimtarit e dramaturgut Fadil Kraja dhe profesorit të paharruar të letërsisë Hasan Lekaj, ka pasur, si të thuash, edhe ai "një karrige" në amfiteatrin e këtij tempulli të skenës, që këtë nëntor mbushi plot 70 vite si një teatër profesionist me vlera të mëdha kombëtare.

U ndala që në fillim tek dalja në dritë e këtij botimi, sepse promovimi i tij në këto ditë ishte prologu i veprimtarive që qyteti i Shkodrës do t'ia kushtonte vitit të 70-jubilar të teatrit të tij, ...



TEATRI "MIGJENI" KUJTESA E NJË KOMBI

KREMTOHET ME MADHËSHTI E NDERIME 70 VJETORI I FORMIMIT TË TRUPËS
PROFESIONISTE TË TEATRIT "MIGJENI" NË SHKODËR

Po e filloj këtë shkrim me këtë përcaktim, duke perifrazuar titullin e librit "Teatri "Migjeni"-kujtesa e një qyteti" të shkrimtarit e studiuesit shkodran Xhahid Bushati. Po e filloj këtë shkrim pikërisht me daljen në dritë të këtij libri brilant që padyshim është një pjesë e rëndësishme në enciklopedinë e kulturës dhe artit shqiptar. Autori i këtij libri dokumentar, profesori i letërsisë Xhahid Bushati që në rininë e tij studentore përkrah pedagogëve të tij të nderuar, shkrimtarit e dramaturgut Fadil Kraja dhe profesorit të paharruar të letërsisë Hasan Lekaj, ka pasur, si të thash, edhe ai "një karrige" në amfiteatrin e këtij tempulli të skenës, që këtë nëntor mbushi plot 70 vite si një teatër profesionist me vlera të mëdha kombëtare.

U ndala që në fillim tek dalja në dritë e këtij botimi, sepse promovimi i tij në këto ditë ishte prologu i veprimtarive që qyteti i Shkodrës do t'ia kushtonte vitit të 70-jubilar të teatrit të tij, të atij tempulli që ka qenë dhe është shtëpia e qytetërimit, kulturimit dhe edukimit, jo vetëm për Shkodrën, por për gjithë Botën Shqiptare.

Vetë autori i këtij libri Xhahid Bushati në fjalën e tij ndër të tjera tha: "Kujtesa e këtij teatri rrezaton e dritëson hijshëm në panteonin e artit shqiptar, ndaj në faqet e librit do të gjeni biografi, interpretime, role, intervista, kujtime, biseda, dëshmi, dorëshkrime, ditare, letra, arkiv, etj, etj".

Në nëntorin e vitit 1949, vetëm pesë vjet pas Çlirimit të vendit, pikërisht në atë kohë kur Shqipëria kishte nevojë për një zhvillim të ri, aq më shumë për arsim e kulturë, trupa teatrore e qytetit të Shkodrës merr statusin e trupës profesioniste, për të hyrë në historinë e artit skenik shqiptar si promotore e një rruge të gjatë e të suksesshme deri në ditët tona.

Formimi dhe konsolidimi i kësaj trupe nuk vinte nga hiçi, nuk vinte nga një boshllëk, të cilin do ta plotësonte si diçka e re, pasi në Shkodër datat e vitet e lëvizjeve dhe shoqërive amatore teatrore dhe jo vetëm, na çojnë në gjysmën e dytë të shek. XIX, në vitin 1861, kur themelohet në Shkodër shoqëria kulturore-artistike "Shkolla Fretnore" për të vazhduar më pas me dhjetra organizime të tilla fetare e laike deri në vitet e Pasçlirimit dhe që janë gjithmonë një fushë mjaft e gjërë për studiuesit.

Teatri i Shkodrës, si një ndër teatrot më të mira të vendit tonë, ruajti traditën më të shëndoshë të shoqërive teatrore. Shoqëria teatrore e qytetit në ditën që mori statusin e teatrit profesionist përbëhej nga: Andrea Skanjeti (regjisor e drejtor), aktorët:



Adem Kastrati, Antoneta Fishta, Ndreka Prela, Çezarina Çiftja, Ndoc Deda, Paulin Lacaj, Vitore Ujka (Nino), Tef Krroqi; në administratë: Zef Jubani (llogaritar), Palok Kurti (sufler), Pjetër Deda (skenograf), Ejëll Gjusi (stilist-kostumograf), Lec Prendi (arkitekt skene); aktorët me një shpërblim mujor u aprovuan: Zef Jubani, Tinka Kurti, Çesk Vuksani, Qaz-

im Lila, Lin Gjonej, Gjovalin Çarkaxhia, Cin Lufi, Mark Bushati, Muhamet Ulqinaku, Halim Kali, Zef Maka, Zef Mirashi, Marie Buçi, Ndoc Harapi, Rrok Sheldia etj.

Nëntori i këtij viti solli pra edhe përvjetorin e 70-të të ditëlindjes së Teatrit "Migjeni" dhe si për çdo ditëlindje, pas këngës "Shumë urime për ty"! që mbarë

qyteti këndoi njëzëri për krijesën e vet, erdhi edhe dhurata që ky institucion ka merituar që në fillimet e tij. Presidenti i Republikës i akordoi titullin e madh "Nderi i kombit" dhe siç shprehet dikush shteti shqiptar nderoi, jo vetëm Shkodrën, por edhe veten.

Trupa profesioniste e teatrit "Migjeni" në historinë e tij 70-vjeçare, të cilën e ka

detajuar e argumentuar me aq pasion studiuesi Xhahid Bushati, ka shumë të veçanta, që rrallë i ka ndonjë trupë tjetër. Ajo ka drejtuesit e vet, ka regjisorët e vet, ka aktorët e vet e mbi të gjitha ka edhe autorët e vet të pjesëve teatrore (dramave e komedive), ku spikat prej afro 50 viteve pena e "Mjeshtrit të madh" Fadil Kraja.

Të pranishmit në këtë promovim, sollen në kujtesë disa nga personazhet e këtij libri, të cilët janë pa diskutim gurëthemeli në godinën e këtij Teatri. Kështu pas fjalës së kryetarit të Lidhjes së shkrimtarëve për Shkodrën Zija Vukaj, mikrofonin do të zbriste nga skena në ndenjeset e teatrit aty ku qëndronte njëri nga gurët e çmuar të teatrit shqiptar, dramaturgu, "Mjeshtri i madh" Fadil Kraja. Ai nuk foli për kontributin e tij, por për shokët dhe bashkëpunëtorët e tij dhe, siç u shpreh ai, si mund të harronte të madhin Serafin Fanko. Po kështu një tjetër divë e teatrit dhe kinematografisë Roza Anganosti, e emocionuar falenderon të gjithë për mbështetjen dhe vlersimin që i bëhet pikërisht nga ky teatër ku ajo ka edhe fillimin e karrierës së saj artistike. Ndërkaq aktori Agron Dizdari do të ndalej dhe



fliste për Bep Shiroken, Rajmonda Mar-ko për një tjetër figurë të skenës, Merita Smaja për Bardh Smajen e kështu me rradhë Zef Deda e mjaft aktorë të tjerë që i kanë dhënë vlera Teatrit “Migjeni”. Më pas ka falenderuar vet shkrimtari Xhahid Bushati të gjithë dhe në veçanti kryetaren e Bashkisë Voltana Ademi dhe drejtoreshën e këtij Teatri Rita Gjeka për mbështetjen që i kanë dhënë në botimin e këtij libri kush-tuar kujtesës së qytetit Shkodër, Teatrit “Migjeni”.

Kjo ceremoni madhështore në shtëpinë e teatrit skenik shkodran e shqiptar kul-moi kur në skenë u ngjiten përfaqësuesit e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta për t'i dorëzuar Teatrit “Migjeni” dekoratën e lartë “Nderi i Kom-bit” me motivacionin: “Si tempulli më i rëndësishëm i dramaturgjisë, qytetërimit, artit e kulturës në Veriun e Shqipërisë. Vlerë e pakrahueshme e trashëgimisë së traditave shkodrane dhe mbarë shq-iptare, duke u dhënë kënaqësi artistike, emocione dhe cilësi estetike artëdashësve të saj të shumtë”.

Ky titull iu dorëzua përmes duartrok-itjeve dhe ovacioneve drejtoreshës aktuale

edhe sensin njerëzor, pasi intelektualët në çdo vend kanë kapacitetet për të njohur e kuptuar shoqërinë, si dhe për të ndërhyrë dhe ndikuar pozitivisht në progresin e saj.

Në veçanti këtë aftësi e kanë artistët, të cilët sikurse ka thënë Robert Shu-mani, e kanë mision të tyre të çojnë dritën në shpirtin e njeriut. Në këtë kuadër regjisorët dhe aktorët e Teatrit “Migjeni” kanë luajtur një rol të pazvendësueshëm në mbajtjen të pashuar të dritës të qytet-arisë shkodrane. Me mjeshturinë e tyre ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm në fushën e artit skenik, kulturës e fjalës dhe emancipimit artistik të qytetarëve.

Por vlerësimet nga shteti shqiptar nuk mbaruan këtu. Presidenti i Republikës akordoi edhe tituj të tjerë të lartë për au-torë, regjisorë e aktorë të shquar të këtij teatri që në fillimet e tij e deri në ditët tona.

Kështu u nderuan me titullin e lartë: “Kalorës i Urdhërit të Flamurit” drama-turgu Fadil Kraja, regjisori Serafin Fanko (pas vdekjes), aktori Lec Bushati (pas vdekjes), aktori Ndreka Prela pas vdekjes, si dhe aktori Viktor Bruçeti (pas vdekjes).

Ndërsa me titullin e lartë “Mjeshtër i

lotëve dhe emocioneve, ajo ka kujtuar partnerët e saj të paharruar “Ndoshta do të çuditeni çfarë do të them. Edhe i shoh moshat e tyre dhe jam unë e vetmja që je-toj me krijimin e teatrit. Nuk mund të har-roj Paulin Lacajn, nuk mund të harrohet Vitorë Ujka, Antoneta Fishta. Pak ishim. Ne e provuam të ishim aktorë sepse vetëm 8 u aprovuam, 8 asat. Mes tyre isha dhe unë, por e fundit, jo e para. Kam pasur fatin të punoj me ata artistë, ata me kanë ushqyer me gji artin, ata më kanë dhënë dorën që mund të ecet në jetë, që të mos jem kurrë prapa, sepse kam jetuar në teatër si gjysmë profesioniste për 5 vjet. I thosha vetes unë jam me këta dhe duhet të matem mirë. Kam qenë shumë e lum-tur që kam punuar në këtë teatër dhe me këta aktorë. Erdhën prapa gjithë ata aktorë të mëdhenj të mirë. Por unë kujtoj ata të vjetrit që mua më kanë ushqyer aq mirë”, shprehet me mallëngjim Tinka Kurti.

Dramaturgu Fadil Kraja “Kalorës i Urdhërit të Flamurit” i shquar për kon-tributin e tij që i ka kaluar edhe kufinj-të e Shqipërisë u shpreh: “Janë monumentet të cilët e kanë bërë të pavdekshëm këtë teatër. Monumenti Tinka Kurti, monu-

Alibali. E them me mburrje se është edhe merita e tyre që mua m'u hapën dyert e suksesit në këtë tembull mbarëkombëtar të artit skenik shqiptar. Unë mendoj se ata meritonin vëmendje më të madhe në këtë veprimtari kushtuar 70 vjetorit të Teatrit “Migjeni”. Faleminderit!”

Fillesat e teatrit në Shkodër që dato-jnë nga fundi i shek. XIX, si aktivitet i shoqërive teatrore e më pas shkëlqimi me statusin e teatrit profesionist, erdhën të përmbledhura edhe në dokumentarin “Teatri “Migjeni” - histori me akte”, re-alizuar nga RTSH me regji të Arjan Çu-liqit. Rrëfimet e aktorëve dhe regjisorëve, të brezave të ndryshëm, ilustrohen në këtë dokumentar nga një arkiv i pasur, me pjesët e zgjedhura nga qindra premierat e vëna në skenë gjatë 70 vite të teatrit pro-fesionist të Shkodrës.

Kjo ceremoni madhështore u përshën-det edhe nga kryetarja e Bashkisë së qytetit të Shkodrës zonja Voltana Ademi, e cila shprehu vlerësimet e saj si drej-tuese dhe si shkodrane për punën e bërë ndër vite nga aktorët e teatrit “Migjeni”. “Për shkodrën dhe shkodranët, tha ajo, është më shumë se një teatër, i ngjason



të teatrit “Migjeni” zonjës Rita Gjeka, e cila nuk i fshehu dot lotët dhe emocionet kur mori në dorë këtë vlerësim.

Presidenti i Republikës, përmes për-faqësuesve të tij përcolli urimet dhe vlerësimet më të përzemërta për këtë in-stitucion që ka bërë histori në artin e kul-turën shqiptare.

Në dritëhijet e kohrave, vlerëson ai, Teatri “Migjeni” ka qenë e ngelet pje-destali i fjalës shqipe që ka ndriçuar më shumë se askush tjetër shpirtin talentin dhe genin artistik të qytetit artëdashës shkodranë. Si një gjest i lartë mirënjohje kombëtare për një pjesë të regjisorëve dhe aktorëve të talentuar shkodranë.

Në një shoqëri demokratike të gjithë qytetarët natyrisht janë të barabartë dhe të dobishëm. Por Shqipëria ka pasur dhe do të ketë nevojë për kontributin e elitës së saj intelektuale, profesionistëve fisnikë, të cilët zotërojnë krahas dijeve, botëformimit

Madh” u vlerësuan aktori i ardhur nga Amerika Ymer Bala, regjisorin Fatbardh Smaja (pas vdekjes), aktorja Vitorë Nino (pas vdekjes), regjisorin Arjan Çuliqi, ak-torja Jolanda Shala (pas vdekjes), aktorja Drande Xhai dhe këngëtari Bashkim Ali-bali.

Gjatë kësaj ceremonie pati një ndërpre-rije të energjisë elektrike për disa minuta, por “teknologjia” e celularëve dhe alegria e publikut shkodran e bënë më gazmore sallën.

Salla u ngrit në këmbë me respekt të thellë kur në skenë u ngjiten dy ikonat e skenës dhe kinematografisë shqiptare, Tinka Kurti dhe Roza Anagnosti, të cilat janë bija të Shkodrës dhe teatrit të saj. Ata u shoqëruan nga aktorët e shquar, tashmë mjeshtër të mëdhenj të skenës Besnik Çi-nari, Zef Deda e Zyliha Miloti.

Aktorja e madhe Tinka Kurti, kujton kolegët e saj që nuk jetojnë më. Mes

menti Zyliha Miloti, monumenti Zef Jubani, monumenti Preng Lëkunda, mon-umentit Ndreka Prela, monumenti Bep Shi-roka e shumë të tjerë që kanë zënë vend në këto pjedestale të pavdekshme”.

Pas përfundimit të kësaj veprimtarie pata rastin të kaloj disa çaste në një bash-këbisedim me prof. e nderuar, drama-turgun e madh Fadil Kraja dhe në bisedë e sipër ai u shpreh: “Festimi i këtij 70 vjetori ishte edhe për mua një ngjarje e veçantë, pasi mos harroni se në këto 70 vite unë kam 50 vite me ta, pra me tru-pen profesioniste të Teatrit “Migjeni”. E kështu unë kam nderin të ju kujtoj se kam punuar në këtë teatër në periudhat më të ndritshme të tij dhe për këtë kanë meritë të padiskutueshme edhe drejtuesit e suksesshëm që kanë drejtuar këtë in-stitucion, ku mund të veçoj Esat Oktroven, njëkohësisht edhe regjisor, Fejzi Spahia, Agim Kodraliu dhe të paharrueshmin Isa

një historie dashurie, e cila përcjell vlerë duke u dhënë një tjetër dimension aktrimit në vendin tonë dhe lotët janë dëshmi e një pune që është bërë me shumë dashuri ndër vite”.

Kjo datëlindje u kthye në një festë madhështore dhe u kremtua ashtu siç dinë ta kremtojnë shkodranët, ashtu siç di ta kremtojnë një qytet i tërë që ndjehet kre-nar për bijtë e saj, jo vetëm në fushën e teatrit skenik, por edhe në të gjitha fushat e tjera të që shoqëria kultivon e trashëgon në kulturë e dije, në art e në sport.

Kremtimi i 70 vjetorit të trupës pro-fesioniste të teatrit “Migjeni” u regjistrua nga RTSH dhe mediat televizive lokale.

Nga RAMAZAN ÇEKA,
Nëntor 2019

PËRURORHET KISHA 800 VJEÇARE NË BALLDRE

Sikur edhe Zoti ishte me ne sot në Balldre të Lezhës. Koha ishte e shkëlqyer. Shirat qëllimisht e kishin ndal turrin. Ngjasonte si një ditë pranvere, e jo vjeshte siç është sot, me 16 nëntor 2019. Bukurinë kësaj feste ja shtuan me dhjetëra e dhjetëra banor të ardhur, jo vetëm nga Balldreni e Lezha. Por edhe nga Shkodra, Tirana e të tjerë. Përrurimi i kësaj Kisha ishte organizuar nga Dioqeza e Lezhës, Instituti Arkeologjik, Konsullata e Nderit e Austrisë dhe Bashkia e Lezhës.

Në këtë përrurim morën pjesë shumë personalitete lokale, qendrore dhe nga jashtë Shqipërisë. Në mesin e të cilëve do të veçoja: Ministrin e Brendshëm z. Sander

Lleshaj, Kryetari i Bashkisë të Lezhës z. Pjerin Ndreu, Prefekti i Qarkut z. Gjok Jaku, Kryetari i Këshillit Qarkut z. Eduart Ndreca, Ambasadori i Kosovës, në Shqipëri z. Sylë Ukshini, Nunci Apostolik në Shqipëri, Mons. Charles John Broës, Konsullin e Nderit të Austrisë, z. Gjergj Leqejza, Ipeshkvi i Lezhës Mons. Ottavio Vitale. Të ftuar ishin nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Kryetari dhe N/Kryetari i Shoqatës, z. Ndue Sanaj e Agron Hasanaj.

Në emër të organizatorëve, përshëndeti të pranishmit moderatoria e Kishës. Ajo u ndalë te puna voluminoze dhe e specializuar që është dashur të kryhej për restaurimin e këtij objekti të shekullit XII e XIII, e cila ishte kthyer po thuajse në një gërmadhë. E gjithë kjo punë e bërë u arrite falë bashkëpunimit të Dioqezës së Lezhës, Ministrisë së Kulturës, dhe bartësit të punimeve dom Nikë Ukgjini. Nuk mund të lemë pa përmendur donatorin kryesorë afaristin Gjergj Leqejza. Kanë kontribuar edhe donator të tjerë si famullitari dom Matteo Piragnola dhe disa donator vendas e të huaj. Për veç vlerës të pa kontestueshme që ka Kisha. Rëndësinë ja ka shtuar edhe muzeu pranë sajë.

Për të përshëndetë takimin, fjalën e morën disa personalitete: Mons. Vittavio Vitale, në mes të tjerash ai u ndal te rëndësia që ka kjo Kishë për banorët e Balldrenit e me gjere, të cilët mund të kryejnë ritet fetare në këtë kishë 800 vjeçare, e cila disa here u shkatërrua, si nga pushtuesit osman ashtu edhe nga diktatura komuniste dhe kjo përsëri i qëndrojë kohës.

Pastaj fjalën përshëndetës e mori Kryetari i Bashkisë Lezhës z. Pjerin Ndreu, ku u ndal te rëndësia që ka kjo

shtëpi e Zotit. Te puna e shkëlqyer e bërë nga specialistët e rikonstruksionit e atyre restauruese, duke e kthyer në një oazë, shpirtëror dhe kulturor për gjithë Shqipërinë. Në mes të tjerash u ndal te puna që do të bëjë Bashkia e

lagështirës, që po shkatërronte afresket madhështore, por Zoti, duket nëpërmjet Dom Nikes e Motrave beri, që ky projekt të mos ndalet, për të mbërritur në këtë restaurim total, të cilin dhe po e promovojmë sot. Të gjithë njerëzit, me një mo-

Ligjëruan, studiues e specialist të kësaj fushe, të cilët u ndalën shkurtimisht te shënimet e fundit të historisë, artit dhe kulturës së këtij objekti me shumë vlerë.

Kisha e "Shën Premtesë", është ndër-tuar mbi kodrën shkëmbore të një vendi mesjetarë. Burimet historike, shënojnë në fshatin Balldre, që nga mesjeta me popullsi të ardhur nga Alpet e Veriut. Kisha i për ketë tipit Gotik. Mendohet se Kisha pati një restaurim në vitin 1462. Kjo sipas mbishkrimit të vendosur në anën e jashtme, ku shkruhet "Në vitin e Zotit 1462 kujto O ZOT shërbëtoret e tu. Për lotet s' bashku me gjithë miqët e tyre"

Objektet e zbuluara janë portrete dhe afreske të një rëndësie të jashtëzakonshme, të zbuluara brenda mureve të saj. Për këto e të tjera u folë gjatë nga studiuesit, Paulin Pushimaj, dom Flavio Cavallini, Reshat Gega, Andi Rembeci, dom Nikë Ukgjini.

Mendojë se kush dëshiron të kthehet pas në kohë, le të vizitojnë objektin e Epokës të Mesjetës. Pra Kishën Katolike të Shën Premtes, së bashku me muzeun pranë saj, ndërtim i shekullit XII, Monument Kulture.

Pozita gjeografike ku ndodhet Kisha, mundëson të vizitohet nga turist vendas e të huaj. Kisha ndodhet 5 km nga qyteti i Lezhës dhe 300 m nga superstrada Lezhë-Shkodër.

Në fund të pranishmit shijuan artin 800 vjeçar dhe muzeun. U njohën me vlerat e larta historike që mbart mbi vete ky objekt.

Kumtesat e zgjeruara do të botohen në një libër të veçantë.

Për të ftuarit u shtrua një drekë e larmishme festive.

Përgatiti Ndue Ziçi



Lezhës në drejtim të ruajtjes, mirëmbajtjes dhe ristrukturimit të gjitha objekteve historike e fetare. Duke përfshirë këtu edhe ristrukturimin e Kishës se Barbanës në Pllanë, krahas turizmit elitare bregdetar e shumë e shumë llojeve të tjera. Ne do zhvillojmë edhe turizmin historiko - fetar. Rikonstruksionit dhe përrurimi këtij objekti shumë të rëndësishëm është një aset tjetër me vlerë, që i shtohet Lezhës, i cili besojmë se do vizitohet nga shumë turist vendas e të huaj.

Të pranishmit i përshëndeti konsulli i nderit të Austrisë z Gjergj Leqejza, i cili u ndal: "Fati e sollë të jem pjese e këtij projekti të shkëlqyer e të kontribuoi në mënyrë modeste, për të bërë të mundur, që në një kohe rekord të mbërrijmë në këtë promovim shumë dinjitoz, nëpërmjet kësaj Konference, me ligjërimi të shkëlqyer. Si gjithnjë ideja lindi e u zhvillua nga i palodhuri Dom Nike Ukgjini, Filloi me ide modeste, për të riparuar vetëm çatinë dhe vendosur dyer e dritare, për të eliminuar mundësinë e hyrjes së

tivim e pasion të jashtëzakonshëm kane qene në dispozicion të realizimit me profesionalizëm e në kohë rekord, Aqipeshevija, pushtetit vendor, instituti i monumenteve të kulturës. Edhe specialistet e profesionistet e lirë të fushës kane qene në dispozicion e shumë bashkëpunues, që kane ndikuar ndjeshëm në realizimin e këtij projekti. Por falënderimi kryesor, përveç Dom Nikes, i shkon Zamirit e djemve, Nikolinit për punën e shkëlqyer për çatinë e muratoren; Marjanit për kontributin në pastrimin e mureve brenda; Gacit për dyert e dritaret; Frederikut për sistemimin e relikteve të gjetura dhe të tjerëve, që punuan me aq kujdes e dashuri për realizimin e këtij projekti. Në fund, jo për nga rëndësia, por për perunjësinë e tyre karakteristike, një falënderim i veçantë i shkon Motrave, që si gjithnjë ishin e janë në shërbim dhe shumë të vlefshme në administrimin e këtij projekti, e kishës në veçanti. Pa dyshim, duke uruar suksese kësaj konference, një falënderim për të gjithë ju, që kenë gjetur kohen të jeni prezent në këtë veprimtari të veçantë."



Dom Nikë Ukgjini



Gjergj Leqejza



Pjerin Ndreu



Monsignor Vittavio Vitale

RËNDËSIA E LIBRIT NË PANAIR DHE JASHTË TIJ

Hapja e Panairit të Librit, siç do vit dhe këtë radhë nga data 13 deri me 17 nëntor 2019, pati rëndësi, për faktin e evidentimit të krijuesve më të pëlqyer, të njohjes me shtimin e blerësve, që tregojnë dhe rritjen e numrit të lexuesve, si dhe fitimin për autor të veçante.

Pallati i Kongreseve priti dhe përcolli dhjetëra e qindra vizitore, dashamires, lexues e botues të librit, të çdo moshe e profesioni, e jo vetëm shqiptarë të Shqipërisë, por dhe të diasporës dhe më gjere.

Në veçanti numrin më të lartë e përbënin nxënësit e cikleve të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme, si dhe ata të moshës së tretë, për të cilët për një pjesë të madhe të tyre, çmimet e larta të librit, ishin të pa përballueshme, megjithëse reklamimin një fare ulje. Por radhe shihje këta të moshuar, pa nipër e mbesa për dore, me libra të dhuruar nga gjyshërit e tyre, sipas dëshirës dhe mundësive të rastit.

E veçanta këtë vit ishte, se kishte shumë përktime nga autor të huaj, autorë të njohur dhe të rëndësishëm të letërsisë botërore, të larmishëm për nga titujt dhe çfarë përmbajtje të afronin. Sigurisht, që dhe shkrimtarët shqiptarë e në veçanti ata të Kosovës, zinin vende të rëndësishme në çdo pavian të shtëpive botuese ven-

dase të ekspozuara në këtë panair.

Dukuri, që po rritet çdo vit, është rëndësia që po marrin botimet e gazetareve, analistëve, personazheve të shoë bizit e të tjera, te vitrinat e të cilëve vërshonin të rinjtë e në veçanti të rejtat, duke u shtyre me njeri-tjetrin për foto apo autografe, duke mos pyetur, çfarë përmban botimi apo sa kushton. Njihet tashme për botime interesante dhe me shumë fitime, Blendi Fevziu. Por me librin e fundit të Arbana Osmani "Receta për 5 minuta" kaloi çdo parashikim shitje, jo vetëm të blerësve, e në veçanti të amvisave të reja, por dhe vetë Arbanës.

E rëndësishme është, që libri të lexohet, të vlerësohet, duke u bërë faktor i rëndësishëm, për marrjen e njohurive nga arti i të shkruarit, nga historia, shkenca, kultura, vlerat e individit dhe të shoqërisë, duke përzgjedhur modele nga personazhe motivues, në veçanti për brezin e ri.

Në këtë panair ashtu siç ndodhe rëndomë, në veprimtari me pjesëmarrje të mëdha njerëzish, formaliteti, pompoziteti, falsiteti, dukej sheshit, duke abuzuar me misionin dhe rëndësinë që duhet të kenë libri dhe në veçanti në shkolla.

Dihet tani, se bibliotekat në shkolla, jo vetëm në fshatra e qytete periferike të

vendit, por dhe qytetet dhe rrethinat të qyteteve kryesore, ato janë në varfëri, ose nuk ekzistojnë fare. Një masë e madhe e mësuesve që japin gjuhë dhe letërsi në ciklin para universitar, me portal e pa portal, lexojnë shumë pak, ose nuk lexojnë fare. E si mund të realizohet lënda e letërsisë, si flitet për autore e personazhe, për rolin edukativ, krijues e motivues, të nxënësit brenda orës të mësimin, ose orët e veçanta të planifikuara për konkurse e veprimtari të tjera letrare.

Në panairin vinin nxënësit të organizuar nga shkolla të ndryshme të Tiranës, por dhe të rrethinave. Të rreshtuar dhe të imponuar të blinin libra, të autoreve të rekomanduara, nga eproret e shkollave ose të institucioneve të tjera arsimore.

E rëndësishme ishte të blinin libra sa më shumë edhe pse nuk i shërbenin programit në shkollë, duke u varur nga shtëpitë botuese, që janë të veçanta nëpër shkolla. Rëndësi tjetër kishin fotot dhe autografet me autorët, vidiot e duke i përcjell përmes portaleve, në kolektiva, shoqërisë e tjerë. Interesante ishin rastet kur nena me fame dhe publike të njohura, blinin libra për të rritur, ua vinin në duar fëmijëve të tyre, të cilët ishin të vegjël, të moshës të ciklit të ulet, të cilët mezi

i mbanin, sepse ishin të rënda e voluminoze, duke e vene në vështirësi fëmijën e tyre, të cilët i harronin titullin dhe emrin e autorit sipas porosisë të mamit. Pasi i bënë fotografi fëmijës së saj dhe vidio, largoheshin të lumtura.

Libri jashtë panairit me siguri do të kalojë shumë vite në shumë raste, në ndonjë qoshe dollapi, duke mos i hapur fletët, e për pasojë pa kryer misionin e tij të rëndësishëm, për shoqërinë në përgjithësi, e në veçanti për brezin e ri, i cili në bankat e shkollës, e ka detyrë sipas programit, i bazuar në cikle e nivele të veçanta, të marre njohuritë e duhura e të domosdoshme për letërsinë.

Informacioni, që merret nga mjetet pamore, po bëjnë që interesi për librin të zvogëlohet, duke bere dem të madh brezave që po rriten. Të menduarit, të krijuarit dhe të vepruarit me logjike të mendjes përmes dijes të fituar nga libri, është bio dhe nuk rrezikohet nga hormone nga interneti me prurje të dëmshme kur nuk kontrollohet e seleksionohet nga ato elemente, që janë të dëmshme për moshën e në raste të veçanta.

Zef Bari, nëntor 2019

E VERTETA E VIZITËS SË MONIKA KRYEMADHIT NË MIÇIGAN, SHBA?!



Kryetarja e LSI-s, Monika Kryemadhi, në vizitën e saj, në Miçigan shkoi dhe u lut në Kishe dhe në Teqe për ne. Dëshiroj që ato lutje të kthehen për mëkatet e saj dhe politikaneve të tjerë, në Shqipëri.

Nuk është krenari për Diasporën dhe as për ne, që tu thurim lavdi politikaneve të padenje për Shqipërinë dhe në veçanti, për këtë parti private (LSI-ja), që nuk e dëshirojnë 95 % e shqiptareve.

Me datën 9 nëntor 2019 në Detroit erdhi Kryetarja e LSI, Zonja Monika Kryemadhi. E pashe tek lajmet në Shqipëri tek 24 Neës, se Monika Kryemadhi u takua me bashkësinë shqiptarë në Miçigan. Bashkësia shqiptare, në Miçigan nuk përbehet nga prifti as nga dervishi dhe as nga 70 veta, që darkuam me te, por përbehet nga 130 deri 150 mijë shqiptarë këtu në Miçigan.

Duke falënderuar 90 % të demokratëve, që ishim në atë salle dhe që pritem këtë force politike të majte, ne këtu duhet të jemi në një takim nacional dhe jo në një takim partiak. Megjithatë dhe në këto takime partiake, duhet t'ju vëmë ne dukje mangësitë secilido politikan, që vjen në bashkësinë tone, të cilët tash tredhjet vite kane drejtuar Shqipërinë (çorientuar Shqipërinë).

LSI-ja është një parti e majte, që nuk

bahet kurrë e djathte, veç shkon here majtas here djathtas për interesat e veta politike dhe për të mbrojtur pasuritë, që ja kane grabitur Shqipërisë gjate gjithë këtyre viteve, sikur edhe disa politikan të tjerë, që e kane plaçkitur Shqipërinë dhe kane çuar Shqipërinë në këtë situatë, e cila është sot.

Edhe dy - tre veta, që i bane pyetje, ajo (Kryemadhi) zgjati nga një gjysmë ore për të kthyer përgjigjet e nevojshme, duke fole vetëm për kundër Edi Rames. Ajo, nëpërmes bisedave të saj përçmoj figura të mëdha politike të PD-s, të cilat kane kontribute të mëdha për Shqipërinë dhe politiken shqiptare, si për Zonjën e Hekurt -Jozefina Topalli. Ndërsa për Zonjën Majlinda Bregu ajo veçse e akuzoj, por u shtri dhe me tej, që duke përçmuar dhe më shumë, me një fjalor të padenje të çdo njeriu, në veçanti për një politikane. Gjithashtu, ajo foli me përçmim edhe për shumë figura të tjera të PD-se.

Asaj i intereson, që të përçaj sa më shume PD-në, për të përfituar partia e saj dhe për te dale sa më shumë e fortë për të ri grabitur pushtet të pamerituar.

Asaj nuk ju kujtua dhe nuk e përmendi se ishte 4 vite në pushtet me PD-në dhe 4 vite me PS-në, që në te dy katërvjeçarët vetëm e voli Shqipërinë dhe sot del e thotë se jam për Shqipërinë.

Në zonën e Dukagjinit nuk kemi pas kurrë gomare, se nuk mund të shërbente në terrenin tone shume të thyer, por kush ka qene i zoti ka ble mushke dhe kur i kemi vu ngarkesat majtas edhe djathtas

për të çua pak më shumë në shtëpi, I kemi vu një ngarkese në mes të dy ngarkesave, e cila ja ka thye kurrizin mushkut.

LSI-ja është ngarkesa e trete, që ja ka thye kurrizin Shqipërisë deri masë mirit.

Unë prita nga intelektualët dhe demokratët, që ishim në salle, që do ti bëjnë pyetje dhe do ti vene në dukje mangësitë dhe çorientimin, që e kane bërë Shqipërisë dhe shqiptareve, dhe do tu dilnin për zot demokrateve, që ajo i përçmoi, të cilët kane dhënë kontribute për Shqipërinë.

E kundërta ndodhi vetëm e uronin me shprehjen "mirëserdhe me krahë hapur".

I vetmi isha unë, që u mundova ti tregoja, se ne nuk jemi ata që pajtohemi me gabimet tuaj dhe një gazetare, që ja përplasi në fetarë Mornikes.

Siç e kemi zakon ne shqiptaret për ti mbajtur anën atij, që e kemi në kurrize, disa prej të pranishmeve filluan të realizojnë me mua për t'ju përlulur Kryemadhit.

Unë duke mbajtur një qëndrim vetëm për çështjen shqiptare pa e ofenduar si personalitet. Unë nuk jam politikan por jam biznesmen, të cilin e kam realizuar dhe mbyllur me shumë krenari dhe humanizëm në shtetin e Miçiganit. Dhe jam i hapur dhe i pafrikshëm para së drejtës.

Fjalët e mija për Kryemadhin ishin këto, përveç si mik mund t'ju them "mire se keni ardhur", se si politikane nuk keni bërë për Shqipërinë as për ne këtu në emigrim, as për shqiptaret në atdhe për tu prite e me u thane "mirëserdhët!"

Ju jeni parti, që kaluat sa majtas dhe sa djathtas jo për hire të Shqipërisë, por

uzurpuat të gjitha drejtoritë e hipotekat dhe ja zutë frymën atij populli.

Tash 30 vjet mbetet duke akuzuar njeri-tjetrin, vodhi ky vodhi ai dhe asnjë politikan hajdut nuk është në burg.

Një pyetje i bana në takim:- A jeni për shumicën apo për t'ju mbështetur here njërës parti e here tjetrës ku t'ju dali interesi?

E mira juaj eshte, qe kur te kthehesh nga Amerika, në Shqipëri, të këshilloj të ngresh Flamurin e Bardhe përprjete dhe të gjithë politikanet, që kane drejtuar tash 30 vjet dhe të vine një fryme e re në drejtim të atij vendi, për ta kthyer dinjitetin dhe shpresën Shqipërisë.

T'ua marrin pasurinë atyre grabitqareve, që grabiten tash 30 vjet Atdheun duke filluar nga Komunitat e deri në Parlament

Ne këtë takim nuk kishte asnjë media për të ndjekur ecurinë, por për fat të mire përdorem celularet.

Pyetjet, debatin dhe sugjerimet, që unë ja bëra me shume dashamirësi Kryemadhit, mos ti marri kush për ters, nga ndonjëri që pret prej saj.

Unë, nuk pres sot përfitim ekonomik nga politika shqiptare, por kam shpirtin e revoltës për padrejtësitë dhe servilizmit.

Kujt i duket vetja i madh, ai mbetet gjithmonë i vogël!

Zoti e bekoftë Shqipërinë, mbasi nuk ka vend me të mirë në bote!

Zoti i ndëshkoftë ata që e çuan Shqipërinë në këtë kaos, që është sot!

Shqipëria bëhet me drejtues të ndershëm dhe të pakorrektaur, duke vene para përgjegjësisë mashtruesit e këtyre 30 viteve dhe grabitqaret!

Ndue Ftoni
Miçigan 14 nëntor 2019

LIBRI I PARË I MEMAJ “SHQIPËRI, O DHIMBJA IME!”


Në mjedisin e lokalit të trevës së Malësisë së Madhe “Kështjella-Xhafajt”, më 24 tetor 2019, në një prani të mrekullueshme krijuesish, poetë e prozatorë, artistë të skenës e të humorit, miq dhe dashamires të librit dhe të poetit Mem Memaj, shoqata e “Shkrimtarët dhe Artistët, Malësisë së Madhe”, promovoi librin e parë poetik të poetit Mem Memaj. Në prani të medias lokale e të një serioziteti maksimal, si respekt ndaj interpretimit e prezantimit të vlerave poetike e divulgative të librit, të pranishmit përcollën me një emocion admirues e profesional vlerat estetike e njohëse të vëllimit poetik “Shqipëri, o dhimbja ime!” të z. Memaj. Pas fjalës së hapjes dhe prezantimit të vlerave të këtij libri poetik, u ofruan para të pranishmëve dimensionet e një libri gjithë ndjesi, dhimbje dhe nostalgji për vendlindjen nga ana e poetit Memaj.

Fjalë gjithë emocion, mbresa e respekt për veprimtarinë e z. Memaj ofruan të gjithë diskutantët, shkrimtarë, poetë, përkthyes, korrektorë letrar, artistë të fjalës, si: Isuf Hebahaj, Fadil Hasmujaj, Dimitrov Popaj, miq, familjarë e të afërm te poetit si: “Mjeshtri i sportit” Seladin Zogu, Rexhep Meta e të tjerë. Emocione të veçanta ofroi, në këtë rast, buqeta me lule, një dhuratë dhe inkurajim origjinal, për poetin më të ri të trevës sonë, nga njëra prej pjesëmarrëseve, në emër të njerëzve më të shtrenjtë, motrave e familjes së tij, të gjithë të pranishëm, në këtë eveniment të poetit Memaj, që prej kaq vitesh jeton në Itali.

Mbresa lenie të veçantë përcolli për të pranishmit fjala e mirënjohjes e poetit ndaj pjesëmarrësve dhe shoqatës së krijuesve malësorë, e shprehur në vargje, prej të cilës zgjodhën këto vargje: “*Kush ka nder e dinjitet / E do shumë vendin e vet / Dhe patriotizmin e demonstron / Në çdo cep të botës ku jeton*” ... Memaj ka lindur më 13. 03. 1949 në fshatin Qafe Grade-Reç të Malësisë së Madhe, në një familje me tradita patriotike, punëdashëse, gjithëherë i integruar në jetën shoqërore të fshatit dhe të zonës Grizhe të trevës sonë, si një familje, që i ka përballuar me dinjitet sfidat e kohës, dje nën diktaturë dhe sot në demokraci. Si mbaron shkollën e mesme për agronomi, në fshatin Reç, Memaj vazhdon studimet në shkollën e lartë “V. I. LENIN”, si dhe kursin një vjeçar për filozofi, në Tiranë.

Dallohet kurdoherë si veprimtar shoqëror në punën me rininë po ashtu edhe si ekonomist, përgjegjës sektori, përgjegjës i burimeve njerëzore në kooperativën bujqësore “Partizani”, Grizhe, po aq edhe si drejtues ekonomie

në nivel kooperative bujqësore në krahnën e Shalës, Dukagjin. Gjithë jetën e tij, kudo ka punuar është dalluar për ndershmëri, përkushtim, solidaritet me njerëzit e thjeshtë dhe ndjeshmëri maksimale ndaj problemeve shqetësuese në popull, duke dëshmuar shpirtin e njeriut të lirë nga filozofia e përjashtimit të tjetrit, siç e kërkonte koha për arsye biografie e të



tjera, si përgjegjës sektori, drejtues partie, kryetar kooperative, apo përgjegjës kuadri për shumë vite në kooperativën “Partizani” Grizhe ku është edhe vendbanimi i tij.

Memaj është i martuar dhe me 4 fëmijë, dy djem dhe dy vajza, me vullnetin e prindit për një ardhmëri sa më të mirë të tyre, si shumë shqiptarë gjatë viteve të tranzicionit, pas viteve “90 merr rrugën e emigrimit drejt Italisë. Me punë dhe përkushtim shembullor ndaj vetes, si qytetar i denjë dhe familjar shembullor, me një vitalitet të pasqorë arrin të stabilizohet, pajiset me pasaportën italiane familjarisht duke arritur të ndërtojë jetën e re si qytetar i denjë i Republikës së Italisë. Gjithë mall dhe dashuri për vendin e vet, nostalgjik deri në skaj ndaj dheut ku lindi dhe u rrit, një ditë të paparashikuar Memaj hyn në jetën e fjalës së shkruar si autor i të parës përmbledhje me poezi, si këngë që rrëfejnë, gjithë dashuri dhe respekt, gjithë mall dhe rebelim, rrugëti-

min e dhimbshëm të vendit të tij, sidomos gjatë këtij tranzicioni të tej zgjatur për fajin tonë, të cilin e përcjell me aq dinjitet: “Shqipëri, o dhimbja ime”. Ky do të jetë edhe titulli i të parit libër me vargje plot nostalgji apo poezi rrëfimtari, kushtuar rrugëtimit të dhimbshëm deri në absurd të atdheut të tij të dashur, i cili, edhe pse pritej të jetonte i reali-

ndjesi të poetit, në kontekstin e asaj anarkie të vitit të mbrapshtë 1997, që marrin jetë në vargjet e poemës “Shpresa dhe zhgënjime” ... “*Edhe tanke dhe avionat, / U grabitën në repartet tona, / Qeveria nuk ekzistonte, / anarkia kudo mbretëronte, / populli i Vlorës u vesh në zi, / Mbasi humbi njerëzit e tij /*, që na sjellin aq bukur në vëmendje thënien e Nekrasovit të madh: “Poet mund të mos jesh, por qytetar duhet të jesh patjetër”: Një mesazh brilant për ata shkrimtarë apo poetucë, humbja e kohës së letërsisë masive, që sot shkruajnë si qëllim në vetvete, larg rolit emancipues të krijuesit në jetën e shoqërisë. Përmes poezisë së tij qytetare poeti Memaj shpreh mjaft bukur ndjenjat dhe qëndrimet e veta, në të cilat jeta personale përjetohet e pandarë nga jeta e vetë shoqërisë ku gjithë përfshihet si qytetar shumë aktiv dhe i ndërgjegjshëm.

Ja sa bukur ironizon me gjuhën e tij poetike mediokritetin politik të ditës përmes karakteresh letrare mjaft të goditura në poezitë: “*Premtimet e Gajushit*”, apo “*Mashtrimet e Sadushit*”: “*Me Jushin kur komunikon, / Aq i zgjuar nuk tregon, / Por ky djalë politikan, / E ka trurin si shejtan, /*

Ndërkohë tek poezia “*Mashtrimet e Sadushit*” ironia si një tallje e hollë, por e fshehur, ia le vendin sarakazmës si një tallje e hidhur, plot vrer, e bazuar në ndjenjën e epërsisë së atij që flet ndaj atij për të cilin po flitet: “*Si kryetar i partisë së majtë, / Thoshte aq thellë i kemi rrënjët, / Sa edhe Xhorxh Bush Junior, / Me na i shkulë e ka zor*”.

Dhe po aq sa ne, emigrantëve shqiptarë, kudo që jemi, na dhemb zemra për Shqipërinë, vendin amë, po aq ndjehemi të brengosur për zhvillimet në Kosovë apo Çamëri, dy gjymtyrët tona natyrore, që, nëse dikush i pengon në rrugën e gjetjes së vetvetes në Evropën e Re, pengesa e parë bëhemi edhe ne, vendi amë, me standardet e paarritura, që ofrojmë me politike bërjen tonë, folklorikë, me komunikimin tonë anakronik, brenda nesh, me diskriminimin e vlerave tona, deri publikisht, në sytë e botës së qytetëruar, nëntekston poeti përmes përjetimit të tij. Mjafton të njihesh sado pak me librin në fjalë të Memajt “Shqipëri, o dhimbja ime!”, për të shijuar dhimbjen e tij, si dhimbja e shpirtit në përprjekjen e pandërprerë për të kapërcyer atë gjendje krize që vijon, në Shqipërinë tonë, deri edhe në ditët më të fundit. Me bindjen se askush nuk na do, po nuk ditëm të duam dhe ndryshojmë pozitivisht vetveten, autori rebelon përmes ironisë dhe qëndrimit kritik, të paanshëm ndaj antivlerave që ofrohen si deri

A DO T'IA KTHEJMË VARRIN P JETËR BOGDANIT?

Një kujtesë për Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Kulturës së Kosovës dhe të gjithë bashkëkombësve të mi të besimit islam të Kosovës.

Me datën 6 dhjetor 2019 mbushen treqind e tridhjetë vjet nga vdekja e Pjetër Bogdanit, klerikut patriot, i cili ju përkushtua me të gjitha fuqitë e tija mendore dhe fizike çështjes kombëtare. Si klerik ai shërbeu si Ipeshkëv i Ipeshkvijve në Shkodër dhe në Kosovë dhe si administrator i Arqipeshkvisë së Tivarit.

Në kombin shqiptar merita më e madhe për punën e tij i njihet jo si klerik, por si mësues i shqipes dhe luftëtar për çlirimin kombëtar nga pushtuesi turk, përkrah forcave të Pikolominit.

Dokumentet nga arkivat e Vatikanit, Padovas, Venecias, Dubrovnikut dhe dhjetëra të tjera arkiva në shumë vende të Evropës tregojnë se ai shtypi librin Çeta e Profetëve, i cili u bë një libër bazë për liturgjinë në gjuhën shqipe por edhe për lëvrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Ai na ka lënë të shkruar lajmin se xhaxhai i tij Andrea Bogdani kishte shkruar një gramatikë të gjuhës shqipe, të cilën para se të arrinte ta botonte, e humbi në kohën e luftës me turqit dhe nuk u botua asnjëherë. Me ndihmën e italianit Barberigo, ai arriti të botonte në vitin 1685 Çetën e Profetëve në gjuhët shqipe dhe italiane.

Në luftën e koalicionit kundër turqve, të udhëhequr nga Pikolomini, Pjetër Bogdani arriti të mobilizonte rreth 12000 luftëtarë shqiptarë, të cilët luftuan heroikisht deri në pikën e fundit të gjakut, por fatkeqësisht kjo luftë nuk u kurorëzua me çlirimin kombëtar.

Janë këto dy vepra të njohura botërisht: botimi i librit dhe pjesëmarrja në luftë, që e kanë rrënjësuar në memorien kombëtare



si një patriot të madh dhe për këtë i këndohen edhe shumë këngë nga popullsia shqiptare e të gjitha besimeve fetare.

Mbas vdekjes, sipas rregullave të asaj kohe, mbasi ishte Arqipeshkëv i Arqipeshkvisë së Shkupit, ai u varros në kishën katedrale në qytetin e Prishtinës, me datën 6 dhjetor 1689.

Barbarët turq, mbas dy javësh, me 20 dhjetor 1689, në shenjë hakmarrjeje për kontributin në luftë kundra tyre, e zhvarrosin dhe trupin e tij ua hedhin qenve në rrugët e Prishtinës.

Ky ishte një akt i turpshëm dhe i pa precedent nga ana e pushtuesve dhe në kundërshtim me të gjitha normat morale dhe fetare për të gjitha religjionet.

Katedralja ku u varros ky prelat u shndërrua në xhami dhe ashtu vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite.

Popullit shqiptar për 330 vjet ju desh ta pranonte këtë poshtërim të pushtuesit

ngadhënjyes me anë të dhunës ndaj tij. Besoj që populli i qytetit të Prishtinës në atë kohë nuk ka qenë dakord me këto veprime dhe besoj që edhe sot mbas 330 vjetësh, pasardhësit e tyre shqiptarë, edhe pse të besimit islam, nuk janë dakord me ato veprime.

Nisur nga sa shkrova më sipër, ju bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së saj të Kulturës, popullsisë së Kosovës në përqindje të lartë të besimit islam, të gjithë intelektualëve, akademikëve, historianëve, shkrimtarëve, artistëve dhe të gjithë atdhetarëve, që t'i thërrasin ndërgjegjes së tyre kombëtare dhe të vendosin ndjenjën kombëtare dhe jo atë fetare në plan të pare, ashtu siç e vendosi Pjetër Bogdani 330 vjet më parë. Kompleksin e përbërë nga një katedrale, një xhami me varrin e Pjetër Bogdanit të përfshira në një, t'a shpallin monument kulture dhe të vendosin jo simbole fetare, por bustin e Bog-

danit me librin në dorë dhe ta kthejnë në një vend ku qytetarët shqiptarë të të gjitha besimeve dhe vizitorët e huaj të njihen me jetën dhe veprën e këtij burri shqiptar, në dobi të atdheut dhe të kombit të vet.

Ky veprim, nëse do të realizohet, do të jetë një gjest i qartë i emancipimit politik dhe fetar të popullsisë së Kosovës dhe një nderim i madh për veprën e atdhetarit të shquar.

Shpresoj që ditën e premtë, me 6 dhjetor 2019, në Katedralen e re të Prishtinës, ku do të përkujtohet dita e vdekjes së Pjetër Bogdanit, të kemi reagime pozitive në lidhje me këtë kërkesë, që nuk është vetëm e imja, por e çdo patrioti shqiptar i çfarëdo besimi fetar qoftë, kudo që ndodhet anembanë botës.

Mark Palnikaj,
Tiranë më 22 nëntor 2019

◀ dje, në emër të pushtetit partiak, ndryshe të vijës së partisë.

Autori ndjehet i lumtur dhe krenar që është shqiptar, sado i larguar prej gati një çerek shekulli nga vendi i tij, po aq sa ndihet i lumtur për Kosovën e lirë dhe të pavarur, sikurse bën thirrje që kjo shpresë të mbetet e gjallë edhe tek çamët, vëllezërit tanë të një gjaku, të një gjuhe e të një kombi, të ndarë padrejtësisht nga shteti amë, duke shpresuar në standardet demokratike të Evropës së Bashkuar ku edhe ne aspirojmë të bëhemi pjesë e saj. Megjithatë gjendja për të qarë e për të qeshur në shumë raste të qasjes sonë, ndaj pritmërive të Shqipërisë sonë të dashur, e mbajnë autorin të zhgënjyer, ndryshe me shpresa dhe zhgënjime të dhimbshme, të cilat së bashku duhet të punojmë t'i përcjellim me dinjitet, nënkupton dhimbja e tij.

Ndryshe Evropa, mbetet larg për të qenë përfshirja jonë, në standardet demokratike, që ajo aspirojnë t'i plotësojmë edhe ne si komb, siç aspiruan breza të

tërë shqiptarësh. Ironia dhe sarkazmat që artikulon autori ndaj dukurive nga më negativet në këto vite të tranzicionit shqiptar, pasojë e abuzimit të institucioneve tona qeveritare me vetveten si dhe e tjetërsimit deri në përmasa absurdi të vetë qenies njerëzore, vijnë si një apel me theks sa aktual, po aq edhe universal, kundër antivlerave me një kosto mjerane për vetë civilizimin tonë si popull, nëse e kemi sinqerisht me vetveten devizën "Evropa e ardhmja jonë!" Nuk ndalet kurrsesi shpërthimi i poetit të tejet indinjuar, plot ironi dhe sarkazëm ndaj idealizmit tonë demokratik, tek poezia "Gajushi", si shprehja më e kthjelltë e anatemit të hipokrizisë sonë civile: "I vendosur Jushi është treguar, / Në banjo të majta nuk ka shkuar, / Këtë veprim nuk e pranonte, / Që të djathtët t'i tradhtonte".

Dashuria dhe malli i pafund për atdheun e tij, ndonëse prej një çerek shekulli i mërguar nuk i ushqejnë gjithnjë besimin tek ardhmëria e këtij vendi, që

thirret Shqipëri ku përmes dy poemave liriko-epike, kushtuar Çamërisë dhe Kosovës, poeti shprehet gjithë respekt dhe ndjesi të hollë, prej patrioti iluminist, në vargun sintetik, aq të goditur "Dy krahinat e Epirit si dy gurë prej xhevahirit".

Mbyllja e përmbledhjes poetike, me poezinë kushtuar "Flamurit kuq e zi", ndërthen në vetvete filozofinë e një malli përvëlues, që mban ndezur shpirtin e njeriut të lirë, dhe përgjithësisht të diasporës sonë, kudo jeton, duke na ofruar si një buqetë prej lulësh të freskëta uniteti, mes veti dhe rreth tokës Nënë, mesazhin më kuptimplotë: "Rebeloj ndaj teje, sepse të dua aq shumë vendi im i shtrenjtë, sepse është pikërisht ky mall dhe kjo dashuri që në shpirtin tonë të trazuar, dhimbja jote vijon të jetë dhimbja e secilit prej nesh, në këtë botë të mbërthyer keq, pas egoizmit dhe individualizmit ekstrem.

Natyrisht libri "Shqipëri, o dhimbja ime!", si i pari i këtij autori, ka nevojë edhe për reflektime më serioze brenda

vetes, sa i takon vlerave të tij letrare, por gjithsesi ai premtion se kush punon dhe e do fjalën si vlerë estetike, ka shansin të jetë nesër njëri ndër anatemuesit më të suksesshëm, të antivlerave të çdo ngjyre, në emër të jetës dhe të dashurisë për fjalën si vlerë universale, po aq për njeriun dhe për jetën, si e vetmja rrugë për gjetjen me dinjitet evropian të vetvetes sonë si populli i civilizuar. Dhe ky mesazh që ofron libri, si një oponencë serioze, në llojin e vet, nuk është pak për një shkrimtar të ri, që jeton me dhimbjen si nderim për vendin e tij, çka mishërohet aq këndshëm, estetikisht, në titullin aq të gjetur të librit, në fjalë, të Memajt "Shqipëri, o dhimbja ime!".

Kadri Ujkaj, kritik letrar,
kryetar i shoqatës
"Shkrimtarët dhe Artistët,
Malësi e Madhe",
Koplik, më 24 tetor 2019

DY TRAGJEDI TË TJERA DUKAGJINASE

- ME RASTIN E VRASJES SË LAZER PJETER ARRA DHE GJERGJ SIMON KRYGJA -



Nga Ndue Sanaj
Kryetari i Shoqates
Atdhetare "Dukagjini"

Me datën 21 tetor 2019 u vra Lazer Pjeter Arra, nga fshati Palaj, krahina e Shoshtit dhe me datën 6 nëntor 2019 u vra Gjergj Simon Krygja nga fshati Sume, krahina e Pultit.

Pra, në keto dy data ndodhen dy tragjedi. Nga një apo disa mendje të ftohta dhe dora e një apo disa njerëzve vriten dy njerëz, dy prind, Lazer Pjeter Arra, lindur e rritur në fshatin Palaj, të krahinës së Shoshtit, banues në Shkodër, rreth 55 vjeç, me profesion bujk, i martuar me dy fëmijë, djalë e vajzë.

Gjergj Simon Krygja, lindur e rritur në fshatin Sume të krahinës së Pultit, banues në Shkodër, rreth 43 vjeç, me profesion bujk, i martuar, me tre fëmijë, dy vajza e një djalë.

Lazeri, me datën 23 tetor 2019 përcillet për në banesën e fundit nga qindra njerëz.

Gjergji, me datën 8 nëntor 2019 përcillet për në banesën e fundit nga qindra njerëz.

U vranë dy NJERËZ në kulmin e moshës së pjekurisë, mbetën dy dhe tre fëmijë jetim, mbeten dy bashkëshorte pa shokun e tyre të jetës. Baba e Nëna e Gjergjit, shumë të moshaur, mbetën pa djalin, dritën e syve! Mbetën vëllezër e motra pa vëlla, të afërmit pa njeriun e tyre, shoqëria pa shokët e tyre, njerëzimi pa dy prej tyre.

Dhe Pse?

Në një shkrim, me titull "U vra një njeri", kam bërë apel, që njeriu të ruhet nga *pasioni dhe ti thërrasë arsyes*.

Vetëm *arsyeja* është ajo që të jep mundësinë për tu larguar nga e keqja.

Vetëm ajo të hap rrugën e mirësisë.

Vetëm ajo të ndriçon jetën për të jetuar në harmoni, në dashuri reciproke.

Nuk mund të ngjasë një marrëzi pa ndikuar mbi secilin nga ne. Të gjithë ne ndikohemi nga njeri-tjetri. Secili nga ne, ka brenda vetës "engjëllin" dhe "djallin", por lumë ai njeri që ka brenda vetës më shumë "engjëj", më shumë mirësi, më shumë forcë arsyeje.

Kur në vetvete mbizotëron "djalli", ligësia, zilia, ndodh dhe kështu ... Më falni t'u rrëfejë thelbin e dy ngjarjeve:

Së pari: Shumë kohë më parë, në gjysmën e shekullit të kaluar, ndodh një

grindje në mes dy djem tezesh! Njeri mendon të pajtohen dhe për këtë le "pengun". Por ndodh "çudia". E ëma nuk pranon, duke i thënë të birit: "Ti s'je djali i im, të mohoj rriten që të kam bërë, gjirin që të kam dhënë, në qoftë se "nënshtrhesh" ..." Djali tërheq "pengun". Pas disa kohësh, djali i dytë, vret të parin me gjithë bashkëshorte ...

Ja çfarë ndodh, kur një femër vetëm di të pjellë, por jo të bëhet nënë ... !

Së dyti: Në dimrin e vitit 1998, një djalë godet me grusht një moshatar të tij, për ... I godituri, shkon në shtëpi dhe i thotë babës, se çfarë i ka ndodhur Baba, i thotë: Mos rri në shtëpi, dil dhe ktheu kur të vendosësh "nderin" që të kanë marrë ...!

Ai del, personin e gjënë dhe e gjuan tetë herë me pistoletë. Vetëm një plumb e merr duke e plagosur lehtë, shtatë të tjerë plumba i shpojnë rrobat e trupit.

Ja çfarë ndodh, kur një mashkull bëhet më fëmijë, por jo të bëhet babë ... !

I theksova këto dy ngjarje, për të nxjerrë një përfundim, për të argumentuar atë që çdo marrëzi nuk mund të ngjasë pa ndikuar mbi secilin nga ne, mungesa e arsyes, pa ndikuar mbi ne, djalli që është brenda nesh. Pra, mbi mua, mbi ty, mbi atë, mbi ato e ata, mbi të gjithë!

Tragjedia e parë ka ndodhur shumë vite më parë.

Tragjedia e dytë ka ndodhur në mesin e viteve 90-të.

Tragjedi të tjera kanë ndodhur pas tyre, siç ndodhi kjo, me Lazer Pjeter Arra dhe Gjergj Simon Krygja.

Kur u shpik arma e shfarosjes në masë, thuhej dhe thuhet se mjafton një neutron i vetëm për të filluar një reaksion zinxhir, që në një çast të vdesin një milion jetë njerëzish. Është e vërtetë, po aq sa është e vërtetë se këtë neutron të vetëm e vë në lëvizje një "neutron" i trurit të njeriut.

Pavarësisht nga kompleksi i mjetit, është njeriu, ai, që eliminon jetë njerëzish. Prandaj thuhet në gjuhën popullore: "**truri është sa një kokërr gruri dhe ku të qëndroj më parë i shkreti!**". Prandaj varret, se ku ajo kokërr "gruri" të ndodhet në vendin e caktuar, në kohën e caktuar dhe për cilin qëllim?!

Kur një njeri vret një tigër, thuhet se është sport, pra gjoja është sport, kur një tigër shqyen një njeri, thuhet çfarë mizorie, çfarë tragjedie, dhe ashtu është për vdekjen e një njeriu nga një kafshë e egër mishngrënëse. Po, kur njeriu vret njeriun, sikur gjuan në një gjah të lidhur, çfarë të thuhet?!

Cili është kafsha e egër mishngrënëse, ai që vuri "mjetin" në punë për të shpuar trupin e njeriut dhe nxjerrjen e gjakut të tij, apo ai që ecte në punën e tij, i cili mund të mos jetë larg shumë në mendësi me të parin?!

Tigri, e kap, e shqyen, jo se ka urrejtje në te, me njeriun, por se në mënyrë instiktive i turret, e rrëzon dhe e shqyen

për t'u ushqyer. Ai, tigër nuk do ta dijë se çfarë është, është njeri me përgjegjësi familjare, apo një kafshë si të tjerat!

Po, ky njeri (ai që vuri në përdorim mjetin) e dinë se nuk vranë thjeshtë një njeri, nuk e çova në atë "botë" një njeri, por dinë se ky njeri do të lëri jetim dy apo tre fëmijë, do të lerë bashkëshorten, nënën e babën, vëllezër e motra, e të tjerë, e të tjerë, që ia kanë nevojën e tij, i kanë nevojën për dashurinë e tij, nevojën për të ndikuar në jetesën e tyre nëpërmjet punës së tij, nevojën që prindërit të "rehatohen" me dorën e tij, që shoqëria, të afërmit ta kenë pranë në gëzime dhe hidhërimë. Pra, ky njeri i bën me bindje që t'i arrijë të gjitha këto. Jo NJERI! Kjo mendësi është mendësi i njeriut primitiv, është mendësi i një shoqërie primitive.

Duke shkuar për ngushëllim, një person pyet: - A i kanë çuar fjalë, se kush e ka vra? Unë, ia ktheva: - Çfarë na duhet se kush e ka vra? Mos vallë kërkoni, që të shkoj "trimi" e tu thotë: - "Mos e kërkoni kund se e kam vra unë, në afërsi të shpisë së lindjes, dhe nesër ti dali kënga ... Ai u pre dhe tha:

-Jo nuk e kam atje, por ka mbete me u bë kjo pyetje dhe heshti.

Shkaku i vrasjes është mendësia, edukimi me këtë frymë, me frymën e gjakmarrjes, me frymën e vetëgjyqësisë, i trashëguar qysh në kohën e shoqërisë primitive.

Një fatkeqësi e madhe që një pjesë e shoqërisë jeton dhe sot me këto mendësi, në fillimet e shekullit XXI. Mund të jenë të vërteta pasojat që e çuan "vrasësin apo vrasësit" në krim, por shtrohet pyetja e thjeshtë:

O njeri apo o njerëz, a e shëndoshe "plagën" tënde?

JO!

Ajo mbeti se mbeti "plagë" e pa mbyllur sa të jeni gjallë.

A është e drejtë që për një "plagë" të hapen "plagë" të reja, të cilat nuk dihet se mund të mbyllën ndonjëherë?

JO!

"Plagët" e reja duan kohë më të madhe për tu mbyllur.

A është e drejtë, pse është një i marrë, është një kriminel, është një si kafshë e egër-mishngrënëse, me një ndryshim, se ecën në dy këmbë, të bëhem edhe unë i tillë?

JO!

Nuk është e drejtë të luftojmë, të hakmerremi ndaj pasojës, ndaj mëkatit se, pasoja është rrjedhojë e një shkaku se, mëkatari është rrjedhojë e mëkatit. Që ne të mos kthehemi në njerëz të "egër", duhet çdo ngjarje, çdo fenomen t'ia japin arsyes.

Njeriu ka arsye, kafsha nuk ka arsye.

Njeriu me arsye nuk mund të kthehet në "kanibal", por gjen rrugë për të evituar të keqen, për të evituar derdhjen e gjakut të njeriut, me të cilin nuk zgjidh asgjë.

O njeri, qindra rrugë më të arsyeshme, më njerëzore, do të ishin gjetur për të

zgjidhur problemin, se sa duke vranë Lazer Pjeter Arrën dhe Gjergj Simon Krygja!

O njeri! Nuk duhet të ecim me mesazhin e së kaluarës, që sjellin trishtime, tragjedi e pasiguri. Me të kaluarën të mburremi për vlerat historike, kulturore, solidaritetin në mbrojtje të lirisë, me vlerat shpirtërore, siç është besa, bujaria, e të tjera virtyte njerëzore, por në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë që të na kushtëzojnë të ardhmen.

E ardhmja nuk është vetëgjyqësi, por ligj.

Në botë ka dy grupe njerëzish: Ata që kanë mend, të cilët janë shumica dërmuese, dhe ata që nuk kanë mend e që janë pakica.

Ata që kanë mend nuk udhëhiqen nga instinkti, por nga arsyeja e për rrjedhojë ecin drejt së mirës, drejt progresit, drejt rrugës së Zotit.

Ata që nuk kanë mend, udhëhiqen më shumë nga instinkti i agresivitetit, për rrjedhojë nuk veprojnë me arsye dhe është e vështirë të ecin pa konflikte, duke ia bërë vetës rrugën e jetës të vështirë e të pasigurte.

"Para së gjithash është më e lehtë të evitosh të keqen se sa ta trajtosh. Një herë po e lejove, e keqja ulet këmbëkryq e bëhet Zot i shpirtit tënd, bëhet më e fortë nga ç'je ti i aftë për ta shmangur, ajo nuk lejon ta ngasësh dhe as ta zvogëlosh", theksonte SENECA.

Me qindra njerëz, burra e gra, të rij e të reja, shkuan këto ditë tek familja e Lazer Pjeter Arres dhe Gjergj Simon Krygjes, për t'iu dhënë forcë, për të bërë përpjekje për ta lehtësuar sa do pak dhimbjen e tyre.

Njerëzit e tyre të zemrës, vëllezër, kushrinj, probatina, miq, të fortë, jepin duhan, kanë qëndrim serioz, duke i thënë secilit *fjalët tradicionale: Ju paftë Zoti me të mira. Paçi faqen e bardhë. Mos u shpenzoni burra ...*

Djemtë, me mendësinë për të qëndruar të fortë para kësaj tragjedie, para këtyre tragjedive janë të fortë, jepin duhan, pyetin, japin bisede ...

Sa keq, që këta djem të rinj, madje dhe njomishte të marrin ngarkesë të peshës së rëndë para kohe, peshën e mashkullit të familjes. Peshë është e rëndë dhe rrezikon me i përkul para kohe!

Çfarë fatkeqësi!

Po, kështu bashkëshortet e tyre, së bashku me vajzat marrin ngarkesë shumë të rëndë. Në baze të tradites qëndrojnë në krye të arkivolit, ngrihen here pas here në këmbë, sa here kush shkon për ti ngushlluar, të cilëve ju japin dorën dhe ju shprehin, me shprehjet popullore "Paçi faqen e bardhë!" "Ju paftë Zoti me të mira!"

Te akivoli i Gjergjit, baba Simon, megjithëse i paralizuar së bashku me bashkëshorten, nënën e Gjergjit, Drande Palokja, të ulur në karrige, qëndrojnë në njerëz anë të arkivolit, te koka e tij dhe vetëm shoqërojnë me sy vizitorët dhe kaq, se nuk janë në gjendje për më shumë.

TERRORI KOMUNIST, NË BURGUN E SPAÇIT!

Zenel Drangu i përket brezit të viteve 70 që në moshë fare të re iu kundërvu diktaturës komuniste, dhe kaloi vitet më të bukura të rinisë në kampin e Spaçit ku vuajti 17 vite burg politikë.

Si Kryetar i Shoqatës së ish të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shkodrës, por dhe si një ish i burgosur Politikë, që ka vuajtur 17 vite burg në atë kamp shfarosës, nuk e ka të lehtë të tregojë historitë tragjike që shqiptarët antikomunistë, provuam torturat çnjerëzore të banditëve komunistë mbi trupat tanë të pafajshëm. Historitë e vuajtjeve njerëzore që u zhvilluan në Spaç, mjaftojnë për të mbushur vëllime sheksperiane. Po ta shikojmë nga ana fizike institucionin e dënimit ai duket shumë i thjeshtë, një godinë, ku strehoheshin mijëra të burgosur politike të pafajshëm, sepse ata kërkonin liri dhe të drejta njerëzore, dhe duke u fokusuar tek ndërtesa tregimet tona do të duken tepër të përcipta për përjetimet tragjike që kaluam ne dhe familjarët tanë. Sigurisht nuk jam në gjendje ti shmangem tundimit për të përshkruar pjesërisht atë, që hoqëm të gjithë ne, që kaluam një pjesë të jetës aty në at kamp shfarosës.

Kampi i Spaçit u ndërtua nga të burgosurit ordinerë në fillim të viti 1968 në një gropë të atij shpati malor pothuajse i zhveshur nga bimësia. Vendi, siç shihet dhe sot apo në fotot ilustruese, është i rrethuar nga të gjitha anët me male që të lejojnë të shihet vetëm një hektar qiell. Duke qene në një shpat mali të thepisur të ftohti me erë e ngricë në periudhën dimërore temperaturat zbrisnin shumë gradë nën zero dhe në verë zhuriteshim nga vapa ku shkante deri në 40 gradë. Nuk ishte vend i pa njohur për strukturat



e diktaturës, që sundonin shtetin shqiptar, sepse në vitin 1953 ata kishin instaluar një grup barakash për punëtoret e ndërmarrjes gjeologjike, arsyeja ishte se nëntoka ishte shumë e pasur me minerale të bakrit dhe piritit, nxjerrja e të cilëve u sillte fitim ekonomik të madh shtetit diktatorial.

Nuk e di në mendjen e kujt lindi ideja, që të përdorte Spaçin, që me një gur të vritet disa zogj (shprehje popullore), por mund të themi me plot gojë, se ishte një mendje sa e mbrapshtë dhe tragjike, se sa inteligjente në shërbim të shqiptareve. Se kur diktaturat nuk e kanë përdorur një objekt për inteligjencë, por vetëm për terrorizëm. Ngritja e këtij kampi pune të detyruar atje, i siguronte shtetit diktatorial jo vetëm burg të tmerrshëm, për të terrorizuar të gjithë ata që kundërshtonin

sistemin e tyre të shfarosjes, që nuk kishte si motër në asnjë vend që kishte sistem komunist. Sigurisht përfitimet ekonomike ishin marramendës, se të burgosurit politik as nuk do të paguheshin dhe ata me punë e tyre skllavëruese pushteti kriminal do të kishte fitime marramendës. Vetë Kryeministri i shtetit të diktaturës, Mehmet Shehu gjatë një inspektimi të zonës me helikopter, u shpreh me fjalët: "Vend strategjik për të burgosurit politikë".

Në prill të vitit 1968, në Spaç arriti kontingjenti i parë prej 600 vetash të dënuarit politikë nga burgju i Elbasanit. Të lodhur e të dërmuar, nga puna që kishin bërë për të ndërtuar fabrikën e çimentos, shteti i diktaturës i shpërnguli në Spaç për të nxjerrë bakër e pirit nga thellësitë e nëntokës së Spaçit të Mirditës. Të burgosurit ordiner të diktuar nga policia kriminale e diktaturës i pritën të burgosurit politikë me thirrjet: "Jua bëmë varrin, jua bëmë varrin juve armiqve të partisë e të popullit!" Ata punonin prej muajsh duke e rrethuar kampin me tela me gjemba, dhe kulla roje për ushtarët. E tillë ishte ideologjia komuniste me konceptin tragjik, Spaçi do të ishte varr për armiqët e popullit dhe partisë. Për 6 muaj në vit, zona e Spaçit mbante një dimër siberian i ftohti dhe ngricat bënin kërdrinë ndaj të burgosurve politikë të pambrojtur me rroba, që ti përshtateshin dimrit. Në acarim e dimrit, të burgosurit politikë që nuk realizonin normën, lidheshin me pranga dhe me kavo çeliku nëpër shtylla, dhe liheshin aty deri sa humbnin ndenjët. Kuptohet, që kushtet higjieno-sanitare ishin për tu vajtuar. Flinim në dyshek të mbushur me kashtë 10 vjeçare, që ishin bërë pluhur.

Në një dhomë flinim 54 veta, me një distancë vetëm 60 cm nga njëri-tjetri. Batanijet i kishim që nga koha e luftës së dytë botërore. Tortura tjetër e tmerrshme ishte qëndrimi në të ftohtë ose të nxehtë pas orarit të punës me pretextin po bëjmë apelin.

Çdo komunikim i policëve me të burgosurit ishte sharje, ofendime, njëllor si kafshë. "Punoni maskarenj" ulërinin në kor xhelatët. "Në Spaç nuk keni për të dal as të gjallë e as të vdekur". Dhe në sulmofshin anglo-amerikanët, sa të zbarkojnë ata në Durrës, ne do t'ju vrasim juve, pastaj do të jua kthejmë armët atyre. Kështu vijonim të vuanim pasojat psikologjike e fizike të oficerëve, komandës, kryekomandantit, dhe komisarit e Drejtorit të kampit. Kur një i burgosur politikë vdiste apo e vriste shembja e galerisë, kufoma nuk i dorëzohej familjes, por varrosej në një vend të paditur. Në mënyrë groteske, burgosja vazhdonte edhe pas vdekjes. Me kalimin e viteve nga 600 të burgosur arriti në 1400. Një formë tjetër presioni ishte ri dënimi pa bërë asnjë shkelje ligjore, shumë nga kolegët tanë i dhanë fund jetës duke mos e duruar këtë padrejtësi.

Në maj të viti 1973 të gjithë burgosurit shpërthyen në një revoltë të padëgjuar në asnjë vend ish komuniste, ku u vranë nga forcat policore 4 veta, dhe u ri dënuan mbi qindra të burgosur politikë. Shndërrimi i kampit në një muze është më e pakta që mund ti shërbejë kujtesës dhe atyre qindra të burgosurve që u sakrifkuan tragjikisht në at kamp shfarosës.

Zenel Drangu

◀ Këta qindra njerëz, nga e gjithë krahina e Pultit dhe e Shoshit, të Shalës, të Shllakut dhe të Temalit, të Mbishkodrës dhe të qytetit të Shkodrës, shumica prej tyre pëshpëritnin vesh më vesh, se në mes vrasësve dhe viktimave ka pasur diçka.!

Shtypi i përditshëm, media vizive jepen versione nga më të ndryshme, për "shkakun" e vrasjes së tyre, por pak kanë rëndësi, që jo vetëm nuk janë në gjendje të përcaktojnë, se cili ishte shkakun që u vranë këta burra, këta dy dukagjinat. Por, flasin e flasin dhe jo vetëm nuk zgjidhin gjë, vetëm se secili mundohet për t'u paraqitë më i dijshtëm, çka tregon ende për një sëmundje, mendësi të një shoqërie primitive.

Këto dy vrasje, këto dy tragjedi janë pasojë!

Mjafton, se janë pasojë dhe jo shkakun, se shkakun dihet! Shkakun, është mendësi e vetëgjyqësisë, mos njohja e shtetit!

Këta njerëz, që sot pëshpëritin, nuk e kanë ditur dje se në mes të dy viktimave e kriminelit apo krimineleve ka pasur konflikt? Përderisa pëshpëritin sot, dje diçka kanë ditur, qoftë dhe ata më të afërmit.

Ku kanë qenë këta njerëz deri më sot? Pse këta njerëz kanë qëndruar indiferent?

Më mirë këta njerëz të kishim bërë

zhurmë dje, duke futur në mes besimin tek Zoti dhe të kishim zgjidhur konfliktin, qoftë dhe me detyrim ligjor, apo sot t'i thuhet njerëzeve të zemrës, djemve, miqve, dhe të tjerëve: "A mund qëndroni?!", e të tjera fjalë pa vlerë, para asaj që mund të ishte zgjidhur para, se me u vra njeriu, para se me u bë një njeri apo disa kriminel.

Me siguri, duhesh bërë ajo e para.

Pse ky indiferentizëm i bashkësisë ku janë lindur e rritur, ku kanë ngritur çerdhen e jetës së tyre?

Çfarë vlera ka ky solidaritet, për të dhënë forcë e për të përcjellë tjetrin për në banesën e fundit, në kulmin e moshës?!

Apo për të treguar se jemi pranë njëri-tjetrit në fatkeqësi.

JO!

Solidariteti është i domosdoshëm në fatkeqësi natyrore, në humbjen e njeriut të dashur nga sëmundje dhe moshë, por ky lloj solidariteti si i këtyre diteve është i panevojshëm.

Ky lloj solidariteti, i kësaj bashkësie që mban qëndrim indiferent para konflikteve brenda llojit, më duket si një farë hipokrizie.

Të nderuar dukagjinat e mi! Të gjithë dukagjinat kanë nevojë për njëri-tjetrin, sidomos në këto raste tragjedi, ashtu siç kemi nevojë për shkodrë dhe shkodranë

për ne, por në mënyrë të veçantë NE, për NJERI-TJETRIN.

Kurrë nuk kemi pasur nevojë më shumë për njëri-tjetrin, se sa sot, që të bashkohemi për të dënuar pa mëshirë, me forcën e arsyes dhe ligjit çdo akt vetëgjyqësie!

Të bashkohemi për të lenë në muze të historisë mendësinë patriarkale të shoqërisë primitive, që kanë lënë "plagë"!

Të bashkohemi për të gjetur veten më mirë në shoqërinë e hapur, në shoqërinë demokratike, me besimin tek Zoti dhe në vlerat absolute të individit, të njeriut!

Të bashkohemi për të zhvilluar fëmijët e tu japim rrugën e ditorisë për tu bërë dikush për vete, për familjen dhe për shoqërinë!

Të bashkohemi për të dalë nga penalizimi i vetvetës, për çdo të keqe që ndodh në bashkësinë ku jetojmë!

Të bashkohemi për të njohur shtetin e të kemi besim te strukturat e shtetit, sa do të brishta të jenë ato, se vetëm kështu do të largohemi nga mendësitë e një shoqërie pa shtet, të një shoqërie primitive!

Ne, nuk jemi e keqja e kujt! Ne, jemi e keqja e vetvetes!

Pse?

Çojuni ju dukagjinat, shaljanë, shoshianë, pultinas, temalas dhe shllakas të rreshtohemi në krah të normave të qytetarisë, për tu bërë qytetar më të denjë

të një shoqërie, që kërkon sa më parë të rreshtohet me shoqërinë e bashkuar evropiane.

Me këtë shkrim, nuk dua të lëndoj asnjë njeri, por të shpreh një shqetësim publikisht të mbarë bashkësisë dukagjinat, të mbarë bashkësisë ku jetojmë, që së bashku të luftojmë "mëkatit", që është vetëgjyqësia e trashëguar brez pas brezi dhe të kemi kurajën të shkojmë para strukturave të drejtësisë dhe të pranojmë atë, që ato do na përcaktojnë, se vetëm atëherë do të marrim statusin e qytetarit.

Të gjithë jemi gatuar nga e mira dhe nga e keqja. "Por në qoftë se dikush e rëndon shokun e përpiket t'i bëjë atij keq, së pakut duhet të "trembet" se të këqijat do t'i kthehen atij vetë shumëfish dhe anasjelltas, kush e do shokun sipas të njëjtit ligj duhet të përpiket ti bëjë mirë atij ...", thekson i madhi SPINOZA.

Të ngrihem në këmbë e të mundim të keqen, vetëgjyqësinë, që na kthen në njerëz primitiv dhe në shoqëri primitive.

Fatkeqësitë, nuk arrijnë të bëjnë bu-dalla asnjë person inteligjent. Prandaj dukagjinat im ta kuptojmë mirë këtë postulat, se shumica e bashkësisë dukagjinat është inteligjent.

NË TERVESEN BUJARE TË BUJTINËS VUKTILAJ

Tashmë jo thjeshtë një bujtinë ku miqtë (rrugëtarët, shtegtarët madje edhe kureshtarët) ndalojnë me bujte, me pushu e kalua natën, por një konak që identifikohet si ajo LAVDA e varur në 'gozhde, në qoshe të forumit "KULLA E VJETËR VUKTILAJ", me taban e me tradita, që vazhdon të ofrojë bujari e mikpritje si Lumi i Vermoshit, që nuk do shteroje kurrrë së vërshuar drejt lindjes, duke sfiduar kështu edhe ligjet e natyrës.

Tek shijon gatimin me prodhimin e gjetur ndër ara, prona të kullës dhe nga gjëja e gjallë e rritur në kullosë alpine e me ujë borë, e të magjepsur nga pasazhi madhështor që të jep petku vjeshtor i natyrës, këndshëm e me kureshtje pyet e dëgjon të tregohen histori të gjalla e të jetuara me mund djersë e sakrificë të mbijetesës së bijave e bijave të rritur në këtë kullë.

Dëgjon histori rrëqethëse, që ndërthuren me dinjitetin që i karakterizon të gjitha kullat e Malësisë, sidomos ato të zonave malore, e në veçanti ato kelmendase, çka len për të kuptuar se në përplasjet e mëdha të erërave politike si nevojë për t'i shpëtua shfarosjes së gjenocideve gjakatare të sllavëve të jugut (e jo vetëm) u tërhoqën në strehët më të larta natyrore. Atje ku mbretëronin akulli e bora, ku duhej sfiduar edhe terreni i ashpër që ngjasonte me hijen e çehres së mugët të një plaku, të pikëlluar për pamundësinë e tij me lëvizje e me i shkund ndër ferishtet e konakut të gjitha mençurit e porosit e

fundit për kullën e vet. Të vetëdijshëm se atje freskonte era e lirisë dhe dëlirësisë u ngjiten duke u bërë njësh me alpet, ku gjallëruan të pathyeshëm me të vetmen pasuri që u nevojitej: "Të kenunit të lirë me jetua".

U shtuan e u shumuan me gjâ e njerëz,



si hojet e bletëve në ballë të pranverës, sa sot prezantohen me familje fisnore e fise të mëdha, duke ruajtur traditat, që i vendosen dhe mbrojtën bashkërisht si amaneti i porosive të lëçitna në kuvendet e pleqërisë prej krejt maleve të Malësisë.

E sot me flaken e pishtarit të zbehtë që

ka mbetur në dyer të kullave të lanuna e të braktisuna nga fryma e gjallume e njerëzve, të ikur e të shtegtuar në kërkim të mirë qenies jetësorë ua kanë tretur freskinë dhe gëzimin edhe këtyre alpeve. Aq sa në rrjedhë të bisedës me të moshumit e kësaj kulle e shprehin me za të mekur këtë trazim shpirti, që i ka plagosur largimi i fëmijëve në dhëna të huaj e mërzinë që kanë kur ja kthejnë shpinën kullës, me ju bashku familjes në mërgim.

Megjithatë ka ende rreze shprese për t'i dhënë jetë e gjallëri kësaj kulle e krejt kullave alpine të Vermoshit, të cilat në piken

jnë të magjepsur nga biodiversiteti alpin e largohen duke marrë me vete mbresat më të mira në kuptimin e plotë të fjalës me dëshirën e mirë për t'u kthyer sa me parë në Vermosh.

Falë ndërgjegjësimit të të rinjve, të cilët e kuptuan rëndësinë që kanë këto kulla, për t'i mirëmbajtur e pasuruar me objekte kulturore, duke koleksionuar gjithçka që demonstroi traditë, ndikoi edhe në nxitjen e kureshtjes se vizitorëve, pasi ishin ata që huazuan risinë e kohës, duke i kthyer kullat në bujtina, të cilët edhe pse në mërgim dhe në mënyrë perio-



e Verës mund t'i krahasojmë me vendet më egzotike për nga numri i madh i vizitorëve, turistë vendas e të huaj, të cilët venë e vijnë me makina e motorra nëpër ato rrugë të asfaltuara, sikur bëjnë garë me njëra-tjetrën, duke shijuar gjithçka që të ofrojnë Bjeshkët e Kelmendit. Qëndro-

dike nuk ngurruan ta përqafojnë edhe turizmin malor si burim i rritjes së mërqinjës sociale në Vermosh, Kelmend e më gjere, ku vëmendja dhe mbështetja nuk mungoi as nga shteti.

Nga **RITA SHKURTAJ**, Nëntor 2019

U NDA NGA JETA, INTELEKTUALI I SHQUAR DUKAGJINAS, KOLË ZEF FUNIÇI

Tani, Kole Zefi nuk është më midis nesh, sepse vdekja ogurzezë e mori në mënyrë të papritur dhe iku fizikisht nga ne, por prania e Tij do të jenë shumë e gjatë në memorien tonë, sepse jeta e tij ishte shumë gjurmëlënëse. Kishim prapë nevojë, që ta kishim midis nesh. La prapa fjalën e mirë nga puna dhe kontributin e tij. La shokë e miq të shumtë, të cilëve ju imponoj shumë respekt.

U lind 81 vjet më parë në një familje të nderuar dhe patriote të fshatit Gimaj, lagjja Kapre e krahinës së Shalës, e cila gjithmonë përkrahu progresin. Vështirësitë e jetës i filluan që herët, por gjithmonë i përballoj me sukses falë vendosmërisë, kurajos e vitalitetit të tij. Që 6 muajsh mbet jetim nga babai dhe u rrit me shumë vështirësi dhe sakrificë nga e ëma. Ishte shumë i etur për dije dhe kurrë nuk i munguan përpjekjet për t'i shtuar ato deri në fund të jetës.

Kontributi i tij për zhvillimin, zgjerimin dhe konsolidimin e arsimit në Dukagjin ka qene i pakrahasueshëm. Që 14 vjeç ju përkushtua këtij sektori. Mbasi mbaroj shkollën e mesme pedagogjike



në Elbasan, e më vonë të lartën në Tiranë, shërbej si mësues e më shumë drejtor shkollë në Breglum, Theth, Abat, Ura e Re, Gimaj, Plan e Toplanë. Kurrë punët nuk i bëri vaj, përkundrazi kudo që punoj shkollat ishin në pararojë të arsimit në Dukagjin e më gjere. Për punën e tij të mirë flasin me shumë respekt ish nxënës, koleg dhe bashkësia. Kanë qene me fat ata që kanë punuar me Te, sepse ishte shembulli pozitiv, shumë bashkëpunues, kritik ndaj të keqes e të metave dhe shumë ndihmëtar me eksperiencën dhe aftësitë e tij profesionale, sidomos për mësuesit e rinj. Ishte drejtues, menaxhues dhe administrator model.

Për disa vite kontributi i tij ishte i madh si drejtues i pushtetit vendor në ish legalitetin e Dukagjinit, ku nën kujdesin e tij pati një hop cilësor edhe arsimit në drejtim të masivizimit të arsimit 8 vjeçar dhe u hap e para shkollë e mesme në Breglum. Ndihmesa e Tij ishte e madhe edhe në drejtim të përmirësimit të shërbimit shëndetësor në çdo fshat të Dukagjinit.

Ju ngarkuan edhe detyra të tjera në sektorin ekonomik duke kontribua në forcimin ekonomik të ekonomive bujqësore në krahinën e Shalës. Kudo, ku punoj e karakterizonte ndershmëria e përkushtimi në punë dhe i prire vetëm për të bërë mirë.

Sa i dashur e human ishte me njerëzit, aq ishte edhe kërkues ndaj të metave e mangësive dhe eliminimin e tyre. Nuk ishte liberal as konformist. Tek Ai ishin në harmoni të plotë vetitë e virtytet më të mira të trashëguara që i kanë qëndruar kohës, me edukatën qytetare të fituar gjatë jetës.

Për punën e bërë në arsim e sektor të tjerë, mori vlerësim maksimal nga strukturat qendrore e lokale, si dhe shoqata të ndryshme joqeveritare, duke i dhënë shumë dekorata e mirënjohje, që e fundit ishte ajo që mori nga shoqata Atdhetarë "Dukagjini" në kuadër të 100 vjetorit të arsimit në Dukagjin, me motivacionin: "Për devocion e përkushtim të përherëshëm në fushën e arsimit dhe ngritjen e nivelit kulturor të bashkësisë dukagjinase".

Kola ishte edhe një prind shembullor. Bashkë me bashkëshorten Linë, të cilën e pati krahu e djathtë në përballimin e vështirësive të jetës, formuan një familje model. Lindën, rritën, shkolluan dhe edukuan katër fëmijë të mrekullueshëm: Kujtimin, Vjollcën, Ardianin e Ajanen, të cilët kanë krijuar familjet e tyre, tre të parët në Amerikë shumë të suksesshëm, kurse Arjana kontribuon në sektorin e ar-

simit. Këta babën e tyre do ta kenë shembull frymëzimi e model në punë e në jetë. Ju la mbrapa fjalën e mirë, shokë e miq të shumtë.

Fëmijëve, nipave e mbesave ju la edhe një thesar, siç është libri i tij "Kujtime e mendime ndër vite", ku paraqet në detaje jetën e tij. Edhe mbasi doli në pension, vazhdoj të jetë shumë aktiv si studiues, hulumtues e krijues. Përjetoj me shumë objektivitet ndryshimet e sistemit duke vlerësuar me realizëm të kaluarën dhe shumë kritik ndaj sistemit të ri dhe dukurive negative që ai shfaq.

Vitet e fundit bëri një jetë midis Atdheut dhe Amerikës. Vetëm këtu e gjente qetësinë. Fati e solli që ditët e fundit të jetës t'i kalonte në Shkodër. U shmall me të afërt, shokë e miq dhe mbasi ndërroj jetë po prehet i qetë aty ku e kishte dëshirën. Me vdekjen e Kole Zef Funiçit, familja humbi njeriun më të dashur, e cila kishte prapë nevojë për prezencën dhe këshillat e Tij; shoqëria humbi një ndër shokët më të mirë dhe Dukagjini humbi një ndër intelektualët më të shquar. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes për humbjen e njeriut të zemrës dhe kemi bindjen e plotë se do ta përballojë me forcë këtë humbje, duke pasur besim se në jetë do të ecin nën shembullin e tij.

I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij! Pushoftë në Paqe!

Prelë Shytani, Shkodër, nëntor 2019

HUMANIZMI I NJË MJEKEJE ZVICERANE, MIKE E SHQIPTARËVE

Duke lexuar Zhyll Vernin që është shprehur aq bukur : « Kur nuk krijoh, nuk ndjej jetë në veten time » mendova tu sjell sot kujtimet e mija te paharruara për një mjeke humaniste zvicerane, me të cilën kam punuar vite të tëra. Prej vitesh kam ndarë me të dhe personelin human mjekues, mjekë dhe infermiere në Gjenevë, para fillimit të një konsulte, « kruasantin » (croissant) dhe kafën e mëngjesit, duke diskutuar lirshëm dhe si midis kolegësh që na bashkon një qëllim : si të përmirësojmë bisedën me një pacient nga Shqipëria, Kosova apo nga viset, Maqedonia e Veriut, apo me bashkëkombës shqiptarë që janë vendosur në Zvicër, qoftë edhe përkohësisht. Kemi folur për atë gruan shqiptare që nuk dinte asnjë fjalë frëngjisht dhe dëshirën e saj për të kuptuar gjithçka nga biseda, për prindin e asaj fëmije që nuk ka konsultuar asnjëherë mjek në fshatin e saj, diku në Kosovë, për mungesë mjekesh dhe personeli mjekësor. Midis tyre, kam pasur rastin të marr pjesë dhe të diskutoj me doktoreshën humaniste zvicerane Marinette Eys, një njeri i qetë, në pamje e ashpër, por tepër modeste, fisnike, dhe e urtë, kur e njeh nga afër. Për të gjithë ata që kanë pas fatin ta njohin, ajo nuk linte asnjërin prej tyre indiferent. Kureshtarë, njerëzore dhe e dashur, ajo vazhdoi në rrevat e jetës, duke ecur në një « udhë » profesionale që dallohej nga autorësia e saj, për një trajtim të ri të sëmundjeve gjenetike, duke përfshirë edhe Talaseminë, që është e përhapur sidomos në zonat mesdhetare : Greqi, Itali, Qipro, Shqipëri, Francë, Belgjikë, Britani e Madhe, Turqi, Indi, Singapor, por edhe në vendet arabe, si Dubai, Oman, Irak, Tailandë, si edhe në Kanada, SHBA, si rezultat i migrimit. Doktoreshë Eys kishte aftësi të bashkëpunonte ngushtë dhe me kolegët e saj të spitaleve të tjera në Zvicër, por edhe jashtë, si për shembull edhe me profesorët shqiptarë të hematologjisë, Selaudin Bekteshin dhe Enis Boletinin. Ajo komunikonte edhe me profesorin e shquar francez, Robert Girot, lidhur me pacientët shqiptarë që kuronte në Departamentin e Pediatriisë të Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Kohët e fundit, pata rastin të shfletoj letërkëmbimet e saj me prof. Enis Boletinin, si dhe me prof. Robert Girot. Ajo shquhej për shpirtmadhësi dhe këmbëngulje për të trajtuar pacientët talasemikë me një terapi sa më bashkëkohore. Ajo ka shpëtuar shumë jetë fëmijësh dhe adoleshentë që vinin nga kontinente të ndryshëm, duke përfshirë edhe nga Shqipëria, Kosova dhe viset. Gjithçka që po shkruaj më poshtë, është një nga mijëra dëshmitë që mund të shkruheshin nga qindra njerëz që kanë biseduar dhe kanë ndeshur me këtë doktoreshë të jashtëzakonshme zvicerane.

Megjithëse i kisha shprehur disa herë dëshirën që të shkruaj për jetën e saj, ajo me modestinë që e karakterizonte nuk ka pranuar, pasi e quante veprën e saj, si

përkushtim modest ndaj profesionit që e kishte pranuar me dëshirë.

Marinette Eys lindi në vitin 1930, në një familje modeste zvicerane dhe shumë shpejt prirja e saj ishte mjekësia, studimi i sekreteve të trupit të njeriut dhe gjetja e rrugëve për të ulur sadopak dhembjet e atyre mijëra të sëmurëve që prisnin diçka më të mirë. Ajo me punën e saj si mjeke, qysh e re fitoi besimin e ekipit tjetër mjekësor, si dhe të pacientëve të shumtë. Komunikonte me ta me një gjuhë të thjeshtë, në frëngjisht, gjermanisht, italisht apo anglisht, kur kishte të bënte me pacientë, dhe me gjuhën mjekësore të mirëfilltë, me ko-



Te Shkëmbi i Kavajës, 7 gusht 2019

legë zviceranë apo të huaj. Shumë shpejt mori titullin e lartë Doktorë në mjekësi dhe në vitin 1973 krijoi Qendrën e Hematologjisë dhe Onkologjisë Pediatrike, në Spitalin Universitar të Gjenevës. Në këtë spital kanë kryer studimet e tyre universitare dhe pasuniversitare edhe shumë mjekë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut që sot kanë edhe titullin profesor në mjekësi. Sot kujtohet akoma me respekt nga ish-kolegët e tij në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës, profesori i dëgjuar shqiptar, Isuf Kalo, i cili ka qene për një kohë të gjatë edhe funksionar i lartë i OMS-it në Koppenhagë. Kardiologjia Ardiana Keta, pas aftësimit në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës ka dhënë përvojën e saj, të fituar në Zvicër, por edhe në Francë, në Spitalin Kantonal të Lozanës, si dhe konsulentë në Spitalin me famë botërore të Zyrihut. Ajo tashmë ka hapur kabinetin e saj. Mjekë të tjerë nga Shqipëria dhe Kosova janë aftësuar në Spitalin Universitar të Gjenevës, dialektologe, dentistë, gjeneticienë e të tjera, si dhe një numër infermieresh që kanë marrë diploma në shkollën e Lartë « Bon Secours » në Gjenevë, partnere e privilegjuar e Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Roel

dhe Jorida Zoga së shpejti, përveç perfeksionimit në fushat e tyre të mjekësisë në Lion, për neurologji dhe laborator për talaseminë, do vijnë edhe në Gjenevë.

Doktoreshë Eys, ashtu si edhe profesor Jean-Philippe Assal që është njëkohësisht anëtar nderi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe ka qene drejtor i një qendre të OBSH-së në Gjenevë, prof. Afksendyos Kalangos, kryekirurgu i famshëm botëror në Shërbimin e kardiologjisë vaskulare (ka realizuar me shumë sukses edhe operacione të zemrës të pacientëve shqiptarë dhe ka shpëtuar mese njëherë, jashtë territorit spitalor me

ishite më e mirë. Ajo iku ashtu e heshtur, me vështrim të pa tronditur në çastet e fundit, e urtë, pa u qarë njëherë. Ajo iku por qindra e qindra pacientë të saj, që tani janë në moshë madhore, zviceranë dhe të kombeve të tjerë që kanë zgjedhur Zvicrën si tokë qëndrimi, edhe për disa vite, do ta kujtojnë Doktoreshë Eysin, si një qenie të hijshme, të gjallë, me fytyrën që i shkëlqente para çdo pacienti. Personalisht, do të kujtoj ditët që kemi kaluar bashkë, jo vetëm kur ajo ushtronte profesionin e mjekes hematologe, por edhe kur ajo doli në pension. Kujtonim çastet e vështira por edhe gëzimin e saj kur pacienti bëhej më mirë ose shërohej fare, në sajë të teknikave të reja në mjekësi. Kujtonim pjesëmarrjen e saj në programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës tek fëmijët Talasemikë. Çdo herë që vija nga ndonjë udhëtim jashtë shtetit, nga konferencat ndërkombëtare për Talaseminë, më dëgjonte me vëmendje. Ashtu si ai profesori i nderuar shqiptar, Aleko Vesho që megjithëse kishte mbushur 80 vjet, i shprehej një mikut tim mjek që t'i dërgoj botime të reja për Talaseminë, edhe ajo ngaqë nuk kishte mundësi të lëvizte më, i priste si ujët e pakët botimet në përgjithësi për hematologjinë, por në veçanti për Talasemikët. Me mijëra faqe të shkruara nga dora e saj, nga përvoja e pasur e jetës mjekësore. Shumë nga to nuk i botoi, pasi nuk i quante si vlera të krijuara prej saj. E gjeta me lot në sy kur shfletonte së fundi revistën me prestigj « Amerikan Journal of Medical Genetics » ku ishte botuar një punë kërkimore e saj në fushën e hematologjisë. Kolegët nuk e harronin, por gjithmonë merrnin mendimin e saj, me gjithë moshën e thyer. Botimi i saj, së bashku me kolegun, docentin Pierre Eacker, « Regresi i insuficiencës kardiake pas administrimit ambulator intravenoz të Desferalit në Talaseminë Majorë » është një udhërrëfyes dhe një dëshmi e punës së saj me pasion, e ndjekjes me përsosmëri edhe të pacientëve shqiptarë. Kishte qene anëtare e Byrosë së Ligës kundër kancerit të Gjenevës, drejtuese e Departamentit të Pediatriisë në Qendrën Mjekësore Universitare të Vodit (CHUV), ku kanë punuar edhe punojnë akoma mjekë shqiptarë që kanë bërë emër në fushën e tyre të specialitetit mjekësor. Ka qene konsulentë e Spitalit të dëgjuar « La Tour » në Gjenevë, si dhe ka marrë pjesë në shumë programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës në Evropë.

Doktoreshë Eys, duke e parë pasionin tim për të mësuar më tepër për Talaseminë, më tha një ditë, pas leximit të dy librave të mi dy gjuhësh frëngjisht dhe shqip « Meditime për shqiptarët, Evropën dhe Kombet e Bashkuara », si dhe « Nxënësjja e etur e gjuhës romanësh », Toena, ku unë kam përfshirë përveç tregimeve, skicave dhe refleksioneve edhe artikuj të mi lidhur me hapat në luftën kundër Ta-

KRYEPLAKU MË JETË GJATË I PLURALIZMIT SHQIPTAR

Me datën. 26 Tetor 2019, në sallën e konferencave të Hotel Colosseo u organizua promovimi i dokumentarit “Rrënja e Lisit-Ndera e Fisit”, kushtuar Pajtimarit të Pajtimit Mbarë kombëtar të Gjaqeve të tri dekadave, njëkohësisht kryeplakut më jetë gjatë të pluralizmit shqiptar, Ndue Ded Kulla (në prag të një vjetorit të ndarjes nga jeta).

Në fillim të herës duhet theksuar, se mënyra e organizimit e kësaj veprimtarie ishte deri në limitet e perfeksionimit. Duke filluar nga ftesat e personalizuara, një auditor i përzgjedhur dhe një pjesëmarrje e pazakontë. Ishin të pranishëm figura e personalitete, deputet e ish deputet të Kuvendit të Shqipërisë, e drejtues të njësive administrative, ish krye komunarë, titullarë të institucioneve qendrore e lokalë, Intelktual të fushave të ndryshme nga Tirana dhe Veriu i Shqipërisë.

Drejtuasi Unionit Mbarëkombëtar të Pajtimit të Gjaqeve dhe përfaqësues nga rrethe të Veriut.

Moderatori i kësaj veprimtarie ishte Dr. Zef Gjeta, i cili falënderoi nga zemra pjesëmarrësit duke i quajtur të pranishmit “Ajka e ajkave”.

Ai u ndal tek puna këmbëngulëse e profesionale e studiuesit Mark Bobnaj, për realizimin e dokumentarit dinjitoz. Njëkohësisht, duke ju kërkuar shumë ndjesë të pranishmeve, të cilët me gjithë dëshirën e mirë për ta vlerësuar Ndue Kullën, në këtë ceremoni ishte kënaqësi, por koha ishte e pamjaftueshme.

Skenaristi Mark Bobnaj në përshëndetjen drejtuar të pranishmeve shprehi mirënjohje të thellë të gjithë atyre të cilët ndihmuan dhe bashkëpunuan përgjatë 10 muajve pa u lodhur në realizimin e këtij dokumentari. Ai theksoi se: “Kjo pjesëmarrje meriton vërtet një tjetër dokumentar.”

Krye bashkiakja e Shkodrës Zj. Voltana Ademi foli për njohjen nga afër dhe bashkëveprimin me Ndue Kullën, që kur ishte prefektë e qarkut Shkodër dhe deputete duke ngritur në pah vlerat e tij burrërore duke e quajtur – “Burrë i Spikatur i Dukagjinit”. Më pas ajo i dorëzoi vëllait të Ndue Kullës, Ndocit Certifikatën e mirënjohjes, me motivacion: „Për kontributin në favor dhe shërbim të komunitetit për më shumë se 25 vite si kryeplak i fshatit Bardhaj dhe si pajtimtar i shumë familjeve dhe fiseve, shembull i vlerave më të mira njerëzore



dhe qytetare gjatë gjithë jetës së tij“.

Ndoc Dedë Kullës, vëllait të të ndjerit Ndojë pasi i ‘ju dorëzua mirënjohja, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në emër të familjes dhe të afërmeve.

Më pas Kryetari i Unionit Mbarëkombëtar i Pajtimit të Gjaqeve, Gjin Marku pasi vlerësoi rolin e Kanunit të Maleve në shoqërinë shqiptare evidentoi vlerat e pazëvendësueshme dhe të pakrahueshme të Ndue Ded Kullës – siç e quajti ai: “Simboli i Pajtimit Mbarëkombëtar të Gjaqeve”, u shpreh se – Ndoja dhe familja e tij ishte modeli më i mirë që ka pasur Pajtimi Mbarëkombëtar në tre dekada,

duke i uruar mbarësi familjes së tij pastaj i dorëzoi djalit të tij Gjergjit, dekoratën më të lartë “Urdhri i Gjergj Kastriotit: - Misionar i Shquar i Kombit”(pas vdekjes).

Z. Gjergj Liqejza, nënkryetari dhe në emër, të Zotit Ndue Sanaj, Kryetar i Shoqatës Atdhetare „Dukagjini”, i dorëzoi titullin „Mirënjohjen e shoqatës atdhetare Dukagjini“, djalit të tij, Kol Kulla, me motivacionin: “Një burrë i shquar i trevës së Dukagjinit, i cili ruajti virtytet më të larta të malësorit në çdo kohë, në kohë normale dhe në kohë të vështira, u shqua si veprimtar shoqëror i lëvizjeve qytetare në bashkinë ku punoi e jetoi në shërbim të progresit. Fjalë ëmbël, i matur dhe bashkëpunues me reputacion”.

Zoti Leqejza tregoi disa nga shumë mbresat e takimeve me të ndjerin Ndue Kulla, në vijimësi për vite me rrallë, por veçanërisht kur ky ishte me detyrën e Prefektit të Qarkut Shkodër, në atë kohë me shumë problem shoqërore e sociale.

Më pas zoti Ilmi Kurti, kryetari i Shoqatës Atdhetare “Malësia”, pasi foli me admirim për vlerat e rralla burrërore, ndershmërinë e humanizmin, që e karakterizonte Ndue Kullën, duke thënë se burra si ky rrallë lindin në trojet tona. Në emër të tre Shoqatave të Malësisë së Madhe, përkatësisht- Muzeut Etnografik të Malësisë së Madhe, të Shoqatës Patriotike Kulturore Ana e Malit dhe Shoqatës Atdhetare Malësia, Ju dorëzua djalit të madh të Ndue Kullës, Sokolit me moti-

vacionin:

“Mirënjohje e thellë për kontributin e dhënë si Misionar i Pajtimit Mbarëkombëtar dhe si kontribuues në ndryshimet në sistemin demokratik. Përfaqësues dhe Kryetar i fshatit për mbi dy dekada në fshatin Bardhaj-Rrethina-Shkodër. Dinjiteti, ndershmëria, përkushtimi, forca morale dhe cilësitë e tij të veçanta e kanë bërë burrë të njohur në mbarë trojet shqiptare. Pasuesi i një prej familjeve më të njohura të Dukagjinit për patriotizëm e kontributin në shërbim të interesave të atdheut”

Me këtë rast përshëndeti gazetarja e njohur Kozeta Bruçi, në rolin e folëses së dokumentarit, e cila ceku disa episode pikante të punës së skenaristit, duke theksuar se një stomatolog tashmë i njohur me dhunti e fantazinë e tij, në shumë fusha arrin të realizojë për here të pare një dokumentar kaq dinjitoz. Në emër të përfaqësuesve të misionarëve të Pajtimit të Gjaqeve të disa rretheve, përshëndeti kryetari i degës së Kurbinit, zoti Gjokë Malçi, duke u shprehur se: “Ndue Dede Kulla nuk ka vdekur për familjen dhe Misionarët, por ai jeton në mes nesh me mirësitë e tij”.

Në fund të veprimtarisë, për një orë e 20 minuta u shfaq dokumentari “Rrënja e lisit – Ndera e Fisit”, e qëndisi gjergjefin e Pajtimit Mbarëkombëtar të Gjaqeve në 3 dekada të përfshira në dy shekuj, kryeplaku më jetë gjatë i pluralizmit shqiptar”

Duhet theksuar se dokumentari u ndoq me shumë vëmendje dhe kërshtëri deri në minutën e fundit.

Më pas, për të Pranishmit ishte përgatitur koktejl.

Ky dokumentar u shfaq i plotë ditën e të shumave, më datë 1 Nëntor 2019, nga TV1 Channel si dhe nga Kanali ADTV ALBDREAMS, në SHBA duke u ritransmetuar disa herë, kanal me siglën e të cilit u realizuan intervistat. Po ky dokumentar është shfaqur edhe nga homologu i tij në Kanada.

Kjo veprimtari përfundoi me opinionin pozitiv se dukagjinasi dine të vlerësojnë ata që kanë merita për bashkësinë.

Korespondenti i gazetës “Dukagjini”



LUMNIMI I NJI MARTESE TË MALLKUEME



Nga
Prelë Milani

I

Ai muzg i cingramtë ra tue u halakatë me borë e veri. Ishte një natë përpara Shën Kollit të diminit. Mehmet Mulosmani mbushi oxhakun rrast me dru lisi, shtroi postin e dashit dhe kalli kamishin tuee tufatë mendueshëm. E kish nda mendjen me shkue nesër për festë te bajraktari i Shalës.

-Oj Lice,- i bzan së shoqes. - Merri hallatet e kafes e hajde te oda e miqve.

- Po, po, more njeri, po vij, - iu përgjigj e shoqja.- Kujtova se mos ka pru Zoti ndonji mik!

- Na pjek kafe, se due me t'kallëzue nji pleqni që kam ba vetë me veti.

-Hajër kjoftë! Po ti nuk je burrë që merr mend prej grave!

-Je bijë burri e grue burri edhe djali t'u ba burrë!

-Po, ia marrtë nana të keqen! Edhe i pllambë ma i gjatë se i ati! Burrà, a thue ke da mendjen me lypë kund ndonji çikë për loçkën e nanës?

- Ma thirr Ramën se e kam nda mendjen.

-Ti fol he burrë, se ka nji vit tue tu lutë për ketë gja!

Licja shkoi te jerevia dhe gjeti të birin tue mbyllë derën e vathës.

-Hajde te oda e miqve, se kam shti xhezen në zjarm. Yt atë më duket se ka nji mendim me lypë nji nuse për ty! Hajde, se ka ardhë koha me ia ba bam. I madhi Zottë ndeshitë në hajër!

- Burrà, qe teke ke djalin, asht ba për nji çikë me ia nxeshtratin. Qebesa, as ma të pashëm nuk e ka Malësia e Gjakovës, zgjidhe thesin e ç' të bardhëhërën do me ba. Duem mik të mirë e çikë të mirë, përndryshe na bahena të dy bashkë e nuk marrim vesh!

Mehmeti hurbi filxhanin e kafes, thithi fort kamishin; shtllungat e tymit, mbasi i kapërdui, i rinxori për goje e hunde dhe iu reshën si mjegulla në kreshtë, mbi kurmat e mustaqeve korb.

Siç e kishte zakon, fliste avash, me

za të butë e të kjartë.

-Bir, tash je rritë e ba për martesë. Meraku ma i madh i jetës sonë si prind asht të martojmë mirë e ta shohim ketë kullë të mbushun me nipa e mbesa. Kena ara, bashtina, livadhe, gja e mall sa gjithë Bujani na kanë lakmi, por Zoti te tana të mirat nuk ia falë kurrkujt. Dera e Mulosmanve që prej 5 brezash asht shtue pak, por edhe sëmundjet dhe pushka na kanë ndjekë tue na lanë në zgrip për mashkuj. Nji familje me pak mashkullimasht si një lëshim blete pa miza punëtore. Martesa o ta rritë o ta ulë deri në fliqje oxhakun. Unë kam da mendjen me lypë nji nuse në derë bajraktarësh. Bija e rodit o djalin o fjalën t'i bjen në konak.

- Burrà, ku asht kjo derë bajraktari: në Gashë, Bytyç, Has apo Gjakovë? Qebesa, cila do kjoftë nuk e ankoj hiç me u ba mik me ne! A nuk po kena djalë, a nuk po kena gja, tokë e mall, a nuk ka mik e vjehërr?!

-Ma ngadalë, moj grue, mos e ço kryet aq nalt, se po shkojmë na me lypë te ata. Dëshiroj me ba mik bajraktarin e Shalës!

Licja vuni duert në krye dhe u çue prej stolit tue thirrë:

- Stakfurullah, stakfurullah! Qysh

nuk po begenisë tanë Malsinë e Gjakovës dhe shkon më lypë nji kaurreshë në Dukagjin? Stakfurullah, stakfurullah! Kur të vijë nusja, duhet me ba gati edhe tharkun, se ajo asht rritë me mish thiot e nuk mund të rrijë pa thi. Allahu të ndjeftë, he burrë, për çka fole! -Grue, shuej e veni fre gojës, se e kalove cakun. Si katolik, si musliman nji Zoti i ka falë. Nuk kemi asnji ndryshim veç se besojmë në Zot në dy mënyra të ndryshme. Nikajt i kem vëlla para pesë faqesh dhe kem kenë kaurr si ata. Ne ndërruam besim prej gazepit me ruejt qeto tulina toket dhe kullat prej shkretimit. Gjaku asht ma i shtrenjtë se besimi, jem shqiptarë që besojmë ndryshe, por kurrë nuk kem pranue të bajmë luftë fetare me njeni-tjetrin. Ti e din se na kanë dekë tre djem e dy çika dhe kurrë nuk jem ba ma shumë se tre mashkuj. Kam pvetë edhe dervishin e Luzhes, i cili më tha: "Mund ta ketë fajin trualli, prandej ban mirë me martue djalin në nji derë katolike, se ka mundësi me e zgjidhë misterin". Mehmeti ia vuni dorën mbi shpatulla të birit dhe vazhdoi arsyetimin.

-Vetëm ty të kam dhe të due ma shumë se gjithçka

vijon nga faqja 11

lasemisë : « Mesazhet lidhur me mjekimin klinik të talasemisë janë të shumta dhe premtuese. Shkencëtarët punojnë në këtë drejtim, por realizimet e tyre do të varen edhe nga pranimi i një mjekimi klinik të përshtatshëm nga ana e vetë pacientëve talasemikë, për të arritur pastaj tek mundësia e një kurimi më të efektshëm". Ajo i jepte rëndësi edhe informimit të familjeve që kanë predispozicion të kenë paraardhës me gjenin e Talasemisë, depistimit të tyre me anë të anketave në familje, gjatë konsultave mjekësore të përditshme apo paralindjes, çka ndikon në parandalimin e sëmundjeve te fëmijët e ardhshëm; shtronte si domosdoshmëri diagnozën prenatale, që falë përparimeve të teknikave të marrjes së materialit gjenetik dhe biologjisë molekulare, është zbatuar që nga vitet 1970.

Një ditë duke kërkuar në dosjet e saj të panumërta, ku kishte shkëmbimet e saj me mjekë të vendeve të ndryshme, më nxori edhe letërkëmbimin me Prof. Enis Boletinin dhe, nëpërmjet tij, me profesor Selaudin Bekteshin, lidhur me trajtimin klinik fillestar të një pacienti shqiptar në klinikën e saj. Bile më tregoi edhe letërkëmbimin me profesorin e dëgjuar francez Robert Giro, një nga njohësit më të mirë të Talasemisë në botë. Ai i shkruante se prof. Enis Boletini kishte komunikuar me të lidhur me mjekimin e disa pacientëve shqiptarë dhe e quante me interes bashkëpunimin me atë mjek shqiptar që e njihje shumë mirë problemin e Talasemisë. Doktorëshë Eÿss kishte miqësi me të, ndaj konsultohej gjithmonë edhe

për pacientët shqiptarë që ajo kuronte me tepër përkushtim e dashuri. Prof. Robert Giro ka shumë botime për Talaseminë. Ai tashmë është një nga bashkëpunëtorët më të njohur të Federatës Ndërkombëtare të Talasemisë (TIF), që kohët e fundit i ka zgjeruar kontaktet me Ministrinë e Shëndetësisë, me mjekët tanë hematologë dhe me shoqatën shqiptare të luftës kundër Talasemisë. Presidenti i saj, I ndjeri, Musa Zenelaj, ishte një anëtar i TIF, me të drejtë vote, midis shoqatave të vendeve të tjera anëtare.

I kujtoja Dr. Eÿss, se ajo ishte gjithmonë e pranishme në shërbimin e hematologjisë dhe rrezatonte akoma me këshillat e saj atje. E kuptonte se i jepja kuraja dhe i vinte keq se, për shkak të sëmundjes së saj, nuk mund të ishte më e pranishme atje; megjithatë shprehte një kënaqësi kur e cilësonin akoma si të domosdoshme në shërbimin hematologjik. Bisedonim në apartamentin e saj në Shampel të Gjenevës, tepër modest për një mjekë të njohur si ajo, me piktura të shumta, dhuruar nga dashamirës të saj. Më tregonte për pasionin e saj, qysh në rinë, për librat, për pikturën, për udhëtimet, për dëshirën e shprehur nga një qytetar belg, mik i saj, për t'u vendosur në vilën e tij, diku në rrethinat e Brukselit... Ajo megjithëse kishte mbetur mik me të, nuk kishte pranuar të largohej nga shërbimi hematologjik pranë Spitali Universitar të Gjenevës, pasi aty ishte kënaqësia, jeta e saj si mjekë. Kujtonte udhëtimet e saj në Evropë, e të tjerë, shërbimet lidhur me transplantimet, bashkë me mikeshën e saj të vjetër, Karolinë Porcher. Kujtonte ato netër pa gjuhë të mikeshës së saj, Roza, e

cila i qëndronte pranë, e qetësonte, i jepte pak e nga pak për të ngrënë dhe ia ledhatonte flokët e saj të bardhë. Disa kohë më parë, pasi pa librat e mi, si dhe botime të shkrintarëve shqiptarë, që i kisha dhuruar apo diskun me muzikë shqiptare të realizuar në Festivalin Folklorik shqiptar nga miku im zviceran, Marcel Cellier, fitues i Oskarit për muzikën e tij, ajo më tha : « Kam letra shqip nga pacientë shqiptarë, por siç e di, unë shqiptoj vetëm disa fjalë shqip : « Mirëdita », « Si ndiheni », « Faleminderit », « Mirupafshim » dhe disa fjalë të tjera. Do të doja të mësoja më tepër »...Unë e dija se gjendja e saj shëndetësore nuk e lejonte të bënte një sforsim të tepërt, por për ta qetësuar i përgjigjsha: « Do ta mësojmë bashkë pak e nga pak ».

Më lejoni t'u tregoj një kujtim të bukur dhe të paharruar për doktorëshë Eÿss. «Mbrëmja e asaj të shtune tek « Victoria Hall», salla më me prestigj në Gjenevë ku shfaqen operat, ishte e mrekullueshme. Çasti më prekës ishte kur orkestra, nën tingujt e "Ditëlindjes së gëzuar" i bënte thirrje një gruajë të moshuar, serioze dhe që nuk flet shumë, por ka një zemër dhe ndjenja njerëzore të jashtëzakonshme. Quhet Marinette Eÿss, por të gjithë e thërrisin Doktor Eÿss. Ajo u emocionua kur Natalia i dha një buqetë të madhe me lule dhe e përqafoi fort si nënën e saj, shenje e mirënjohjes për vitet e një jete të lumtur, në sajë të kujdesit të treguar nga Doktorëshë Eÿss. Ajo vazhdonte ta mbronte atë dhe Natalia e adhuron me një pasion të jashtëzakonshëm. Ajo u përgjigj me shumë modesti kur kolegu i saj më i ri fliste për jetën e saj në shërbim të qindra e

qindra njerëzve.

Ajo ka punuar qysh prej afro tre dhjetëvjeçarësh në spitalin e fëmijëve në Gjenevë. Ajo ka parë të kalojnë para saj fëmijë që vuanin, që luftonin për një jetë më të qetë e me më pak halle, që diti t'ua ulë dhimbjet; ajo ka parë fëmijë që në fillim kishin frikë nga spitali, dhe analizat, që vinin nga zona të thella të Kosovës apo vise të tjera, por me butësinë e fjalët e saj, ajo mundi t'i bindë për dobinë e trajtimit. Se bashku me ekipin simpatik dhe kompetent të Hematologjisë, ajo bënte gjithçka për t'u kujdesur dhe shëruar fëmijët e prekur nga sëmundjet imuno-deficitare etj. Shpesh ajo qëndronte vonë në spital, pranë fëmijëve të sëmurë; diskutonte me ta dhe gjente ilaçin më të mirë duke u konsultuar me kolegët e tjerë specialistë që përfaqësojnë një ekip kompakt. Megjithëse e kishte kohën shumë të zënë, ajo ishte gjithmonë e gatshme t'i dëgjojë. Ajo jepte mendimin e saj dhe bashkëpunonte me shoqatën ARFEC në Gjenevë që organizon shumë veprimtari për fëmijët e sëmurë, ekskursione në Zvicër, Francë, kampe pushimi, udhëtime tek Eurodisnei e të tjera.

Mbrëmja tek Viktoria Hall do të mbetet e paharrueshme për të gjithë ata që morën pjesë dhe admiruan gjithashtu orkestrën e artistëve të Lozanës. Ishte një kujtim i bukur për punën e përkryer që doktorëshë Marinette Eÿss ka bërë në shërbim të njerëzve, të fëmijëve dhe të adoleshentëve zviceranë, shqiptarë, arabë, italianë, britanikë, portugezë e kombeve të tjerë që e përbëjnë Gjenevën multietnike».

Përgatitur nga Alfred Papuçiu, Zvicër

shëh syni. Ti je djalë i urtë si me kenë hoxhë. Malësia asht e mbushun me belaxhi mendjekobure, të gatshëm me vra, me pre e me ba rangje. Për çdo sene po na bajnë dame në kullosa e bashtina. Ma kanë shty kufijtë në disa vende e nuk të kam thanë, se nuk due me të shtie në ngatërresa me askënd. Ka asi të paudhë që janë gati me na vu pushkën, me na qitë fare e me na marrë hisen. Unë due me ba mik bajraktarin e Shalës, me pru farën e atij burrnimi në oxhak, me e shtue robninë. Kem nevojë për një mik të fortë, me e pas pritë mbas shpine me turk e shkja edhe ndaj ndonji grabitqari të çmendun që mendon të na marrë nëpër kambë.

-Burrà, nuk e kam mendue kaq thellë, - shfajësoi veten Licja. - Dera e bajraktarit të Shalës asht e njoftun ndër male, veç duhet me folë me hoxhën me çue nusen në xhami e me kthye në fe tonë.- Mos u piq para kohe moj grue, po shkojmë e lypim një herë, po qe shkrue e po e marrim, bajmë dasmën, masandej po shkojmë te hoxha.

-More njeri, unë nuk mund po rri pa folë. Kur të shkosh te bajraktari i Shalës ai të qet raki e venë e qysh po ia ban ti me ndej ninushëm në tervesë.

-Nuk po rri aspak, por po pi gotë për gotë me bajraktarin dhe qysh tash e mbrapa kam me pi e me qitë edhe në tervesën teme.

-Ai ka me pru mish thiut dhe qysh po ia ban, more njeri?!

- Shën Kollin e festojnë me mish dashit, por në kjoftë kismet me e ba mik kam me shkue çdo vjet në gostë, kam me hangër mushkni e krye thiut.

- Të faltë Allahu, çka po flet more burrë! - Mëkat asht me ba keq, jo me hagër e me pi!

Rama nuk shprehu as një kundërsh-tim, por i kujtoi të atit, se puna e fesë asht handek i madh ndamës. -Qashtu si nana eme i paragjykon ata, qashtu edhe bajraktari i Shalës e nana e çikës na paragjykojnë ne. Edhe ata e kanë të vështirë të bajnë miqësi me një mysliman, kur gjithë krahina ka pranue me ndejtë si anxa në zguer veç mos me ndrëshue besim.

-Kjosh e pleqnosh bir, më pëlqeu arsyetimi yt i pjekun! Nesër asht nata e Shën Kollit, në ketë natë falen gjaqe e varrë. Tue kenë se asht natë e madhe, po i kërkoj një çikë. Nuk po ia kërkoj vetë, por kam fol me i ra në derë me Kukel Currin e Nikajve. Kukelin e kem mik të vjetër buke e bajraktari i Shalës e ka probatin dhe asht i vetmi njeri që mund ta mbjellë farën e miqësisë mes nesh. - Mirë, more tatë, - miratoi Rama. - Paç fat e kambën e bardhë!

II

Mehmeti dhe Kukeli udhëtuan gjithë ditën, nata i zuni te pushimi në



Kulla e Mic Sokolit

qafë të Ndremajës. Shtrati i borës i premë prej rrugëve e bilurta, hana si ditën, kullat e bardha me çati trapezoidale, oxhaqet që tymonin pa ia nda, i jepnin antiklinalit të Shalës pamjen madhështore të perëndeshës Ilire të dashunisë, Prenda, veshun me vello nusënie, stolisun me aksesorë me tonalitete të ftohta, plot ngjyra të gjalla e të shkëlqyeshme. Mbas shkoi një sahat natë, rruga i solli në derë të bajraktarit të Shalës. Kukel Curri, përtej shtegut të oborrit thirri:

-A do miq, ooo Lul Shala?!

-Hoshgjeldën, o probe! - iu përgjigj bajraktari dhe fluturimthi u çue e u doli përpara miqve. - Mbramja e mirë u kjoftë e mirë se u pruni Zoti. Ardhsh i bardhë Mehmet Mulosmani, edhe ti probe, të paftë Zoti që na nderove në ketë natë të madhe!

Robnia, që ishin ulë ndër stola afër zjarmit, u çue në kambë dhe u liroi vendin mysafirëve. Mark Lula, djali i ri i shtëpisë, që po sillte ferligun, gjithë mirësjellje u mori armët e krahut dhe i vari në kuj, në qoshe, mbas derës. Bajraktari, mbasi i la t'i jepnin dorën të gjithë robnisë, i ftoi miqtë të uleshin në dy poste lëkure skopanash. U lëshoi kutinë e duhanit, u pveten dalë kadalë me njeni-tjetrin, u vu xhezja në zjarm e pinë kafe të moçme. Filluen të flasin për punët e senës, hyqymetin, motin, kanunin dhe ndodhitë e kohës në Shalë, Nikaj e Krasniqe. Bajraktari, si burrë i mprehtë që ishte, e kuptoi se ardhja e tyne nuk qe krejt e rastësishme, por bani sikur nuk po kupton as gja. Miku nuk pvetet prej kah vjen dhe për çka shkelë në pragun e tij. Psenë e ardhjes e zbardhi Kukeli, i cili kishte marrë përsipër barrën e randë të ndërmjetësit.

- Probe, Mehmet Mulosmani i Bujanit të Krasniqes më ka marrë me veti

me të ra në derë sonte në ketë natë të madhe, se dëshiron me përzie gjakun me ty. Mot mbas motit konakut as meshkujve të tij në gjithë Malësinë e Gjakovës s'ia ka ndalë kush bijën, por ai e ka ba njet me të zgjedhë mik zemre e shpirti! Prej trungut të tij me za mashkujt s'mbijnë shpesh, edhe në mbifshin nuk i len pa i pre pushka a dergja. Mehmet Mulosmani asht gati me të dhanë djalën e vetëm për gjakun tand. Prej këtij trualli kryeprijësish kërkojmë një duvak me përtri, rritë e forcue oxhakun e Mulosmanëve. Kukeli ishte orator i shkathët sa nuk i binte fjalë në tokë, prandej bajraktari ia preu fjalën me marifet. Me urtinë e dallueshme të një kryepariku të sprouem iu përgjigj:

-Mehmet Mulosmani e Kukel Curri, ma paçi faqen e bardhë që më nderuet me praninë tuej në ketë natë të madhe! Ardhja juej në vatrën teme asht nderë! Nderuet gojën tuej për çka folët! Unë ndoshta nuk i meritoj te tana ato lavdrime dhe nuk e di a mundem me u mbushë krahun me u ba mik me shpinë e Mulosmanëve! Me kenë çikat e mia të bijat e Gjergj Kastriotit apo Lekë Dukagjinit, nuk kam si e përbuzi Mehmet Mulosmanin as djalën e tij. Probe, më ke ra në derë me ketë burrë të nderuem, që e njeh Malsia e Gjakovës e Dukagjini. Më zutë ngushtë në një natë kaq të madhe. Nesër Shala ka me thanë "Shtylla e bajrakut, ruajtësi i Kanunit dhe i besimit tonë, i pari në 700 shpi, prishi traditën dhe shiti çikën te dera e pasun myslimane e Mulosmanëve në Bujan". Kjo gjendje shpirtnore më thotë me i dhanë vetit afat. Nuk jam në gjendje të jap një përgjigje flakë për flakë pa pvet edhe robtë. Nata asht e jona dhe kem kohë e flasim edhe mbas darke; mandej, siç thoshte em gjysh, dritë i baftë shpirti

"Nata asht këshilluesja ma e mirë me peshue një mendim të pjekun".

- Probe, mos t'u prishtë as një fije qefi! Sonte asht nata e Shën Kollit dhe po e festojmë si e kanë adet malet tona.

U lanë duarsh dhe u rreshtuan rreth tervesës Kreu i vendit në Dukagjin i përket mikut dhe aty sonte nuk mund të qëndronte askush tjetër veç Mehmet Mulosmanit. Tervesa që mbushë deng me djathë i pa mazitun, i njomë dhe me krypë, mushkni të pjekuna në thupëz në prush për kadalë, petulla e mjaltë, kos të kulluem, kërtolla të skuquna në tlyen, turshi, specat të regjun në shllinë kosi, tharba hudrash, arrash e lejthijash, ftoj, molla, rrush të thatë. U hapen dyert dhe dritaret. Bajraktari i tha djalit Mark Lula:

-Tatà, na i ndez qirat se të ka ma hije ty se plakut!

Bajraktari i vogël ndezi qirin një kullaç okatar e puthi, bani kryq dhe tha:

-Për hatër të Zotit e kësaj nate, - e shkoi dhe e vuni në prag të oxhakut!

Për festë bahet nga një qiri për njeri ose, kur asht okatar si ky, u jepet të gjithve dorë më dorë me e puthë e me ba kryq. Djaloshi bani një veprim të squet mos me vu në siklet Mehmet Mulosmanin, që ishte në krye të vendit. U thirr rakia.

Mark Lula i ri u ngrit në kambë, mbushi gotat, tue zgjatë rakinë prej një ibriku gjakove çep gjel. Gotën e parë për fillimin e rakisë ia dha babës. Luli u mpi pak tue mendue si me ia ba se miku nuk e pin as rakinë as venën e pije të tjera nuk kishte malësia. Kuke-li, si velet që ishte, i erdhi në ndihmë bajraktarit:

-Probe, thueji fjalët rakisë, se Mehmet Mulosmani qysh sot e përgjatë mot ka vendosë me pi raki e venë!

-Probe, gjithmonë të kam fishek në vajicë, më bane nderë që më kal-lëzove. Nuk deshta me iu falë as me i afrue një gja, që e ka të ndalueme.

Bajraktari mori gotën e rakisë dhe tha:

-Kjoftë lëvdue Krishti dhe Muhameti! Mirë se ju ka pru Zoti e kjo natë! Ju sonte po nderoni Shën Kollin dhe mue! Të jam falë Mehmet Mulosmani!

-Me nderë u falshim e u pashim!- iu përgjigj i krasniqi, i cili uroi:

- Krishti e Shën Kollit pushofshin dhe e ndihmofshin ketë derë dhe tanë bajrakun e Shalës! Festa, gëzime e dasma festofshim e hangshim tanë bashkë...

Festa zgjati deri vonë, e gëzueshme, e miradijshme, e hareshme si nata e shekullit në male, ku edhe ma i vobekti feston si aristokrat. Si mbaruen darkën, u çue tervesa; gratë rangatare përgatitën shtrojat për miq e për vete. Rreth oxhakut, me një kungull venë përpara, mbetën Bajraktari, Kukeli dhe Mehmet Mulosmani. I krasniqi, tue pi duhan avazh - avash

e hapi edhe një herë muhabetin që kish nisë Kukeli.

-Bajraktar, nuk po due me të marr turr, mbasi nuk kam çka me u shtue fjalëve të Kukelit.

Të kam tundue, se të kam ra në derë me ma të madhin dashamir që ke, natën e qirit, kur falën gjaqe e varrë. Shën Kollin e festojnë, jo vetëm kshtenimi, por dhe shumë myslimanë. Kam ardhë me dëshirë të thekun në zemër me të ba mik. E di se feja nuk na lejon me përzie gjakun. Te bajraktari i Shalës nuk kam ardhë veç me zanë një çikë, por një mik të veçantë në male.

Farën e fortë të mashkullimit tand due me e mbjellë në oxhakun e Mulosmanëve. Nuk e di sa çika ke, por t'i ruejt Zoti mashkuj e femna! Edhe me një sy, edhe me një kambë në kjoftë vajza jote due me ia ba ortake jete djalit të vetëm. Djali, që besa, për dokë edhe një ma i pashëm nuk asht në tanë Krasniqe, për okë asht i ri, por ishalla, e ndihmon ora e oxhakut.

Bajraktari e ndjeu veten në mes dy pritave, të probatinit dhe të krasniqsis, që i kërkonte miqsi. Gjatë gjithë darkës i kishte thirrë mendjes me gjetë një marifet që t'i delte këtij laku. I kishte mbet vetëm "fisheku" i fundit dhe e provoi mbi Kukelin:

- Probe, a e ke mprehë boshtin si për mue si për veti sonte?


-Bajraktar, më randove në votër tande. Pasha kishën e Nikajve të m'kishe ra në derë siç të rashë unë ty për ketë dashamirë, e kisha ba mik kreje sonte.

-Probe, fute xhezen në zjarm, na i pjek tri kafe të mira! Për hajër na kjoftë miqsi me Mehmet Mulosmanin!

Në përfundim të urimit zani i pësoi një kordë valëzuese jashtë temperit të zakonshëm. Bajraktari i hekurt i Dukagjinit ndjeu një tronditje të fuqishme në krahnor. Me një fjali dëshirore kishte thye tabunë që trondiste malet, të cilën e kaloi me një drithërimë zemre. Kafet i pinë nëpër kangë të gjelave. Pa mbarue filxhanat, bajraktari, që e dinte mirë se e shoqja nuk binte kurrë pa shkue edhe ky në shtrat, i bzani:

-Lulë Bale, hajde e merri filxhanat dhe na ban edhe ti përhajrimin, se sonte jem ba mik me shpinë e Mulosmanëve. Lula hyni mendueshëm. U mundue të diftohej e buzëqeshun, por në zemër ndiente diçka si mella, që i rëndonte si gur mullini i dalë prej imshite. Thonë se zemra e nanës, pa kujtue as vetë, parashih herë-herë të ardhmen e fëmijëve të vet. As ajo e as njana prej vajzave të saj nuk e kishin mendue, as nuk do ta dëshironin ketë miqësi ma fort se krypën në sy. Gjithsesi kishte një parandjenjë të mirë në fatin e kësaj feje, që u ba natën e Shën Kollit e lidhi dy familje me fe të ndryshme.

Kanuni e Bibla, rregullatore të jetës në male, mjerisht i kanë rezer-



Bjeshka e Pevcajve

vue grues shqiptare paragrafe diskriminues. Kanuni ynë gruan nuk e ban skllave, por nuk i jep të drejtat që duhet t'i përkasin. Gruaja nuk mund të përzihet në fejesë as në martesë të bijave dhe aq ma tepër këto të fundit të zgjedhin vet fatin e vet. Lulë Balja ishte bijë Shoshi, e një dere parike të njohun e autoritare, zojë shtëpie e squet, që kishte pritë e gostitë burrat matë fisëm të maleve në konakun e saj. Tagrin e fjalës e kishte fitue me urti dhe guxim.

-Kafet e përhajrimin pihen me raki, i qortoi Lula dhe shkoi e solli ibrikun dhe gotat e rakisë. - Grue, të pleqnoftë djali se as mue, as Kukelit nuk na shkoi ndër mend!

- Djali, që besa, gati asht ba për pleqni, por thirre afër vetit se asht ka fejon motrën sonte.

-Të lumtë goja, moj shoshjane, se si bija e kujt je boll mirë fole!

- Kukel, Kukel, - ndërhyri bajraktari, - leni sherritë! Nuk e pata në mend me dhanë fjalë sonte; më rrethove me Krasniqe sa nuk më le derë as prezore me dalë. Tash m'i bahesh krahn Shoshit.

Djalit i pati ardhë koha me fjet gjumë, por Mark Lula nuk ia ka prishë qefin, as kthye fjalën kurrë babës.

- Shko probe e çoje prej gjumit. Grue, mue e Mehmetit na prij e na ço

të dhoma e gjumit të vajzave. Mik, më preke në zemër kur u betove se edhe me një sy e me një kambë në kjoftë e due për nuse vajzen tande. Unë kam tri vajza, që janë ka fjejnë bashkë në një shtrat. Hajde e zgjidh cilën të duash dhe ta gëzofitë djali!

- Bajraktar, vallahi, nuk mundem me e ba ketë punë, por me jep cilën të duash ti!

-Mik, mendohem mirë, para se me folë. Kur flet bajraktari Shalës nuk ka kthim mbrapa m'e ditë se shembet Biga e Gimajve. Kur shkuen te qilari ku po fjenin çikat, çka me pa. Tri çika si tri molla në një rrëfanë, tri fytyra hanore buzëqeshja e të cilave ishte muzika e shpirtit të tyne. Njena ishte në mes dhe i kishte hedh dorën sipër motrës që kishte në të majtë, ndërsa e treta flinte në krahn e djathë me dorë nën krye. Mehmet Mulosmani, edhe pse i ndrojtun si nusja kur hyn për herë të parë në qilarin e martesës, lëshoi një shikim të shpejtë e zemra iu ba mal, se kudo që të zgjidhte test e gjylishte me dhjetë. Drejtoi gishtin tregues te çika që flinte në krahn e djathë dhe prej emocioneve sytë iu mbushën me lot. Iu duk vetja si në andërr mbretërore, zgjodhi mik e zgjodhi çikë! Kurrë në jetë të vet nuk ishte ndie ma i gëzuem dhe i lumtun. Kur të shkante në Krasniqe kishte çka me kallëzue: vajza e

bajraktarit të Shalës për soj e për dok nuk ia lëshonte rrugën as një çike në malet e Dukagjinit. Nana Lulë e foto grafoi me bish të synit ngazëllimin prekës të krasniqsis dhe gjeti rastin, me stilin e saj inteligjent, ta urojë:

-Mikà, qebesha, pra ma të mirën çikë ma more! Ta gëzofitë djali, ta përtritë e ta rritë oxhakun!

- Mora bash ate që ka shkruie Zoti. I ndjesh zanin e mirë e martosh djem e çika, moj Lulë Bajraktarja!

- Mikà, martesja asht me të shkrueme, por po të la një amanet: Pashë emnin e Zotit, mos m'ia mbulo qatë fytyrë si hana kësaj çikë me ferexhe, as mos ma mbyll mbrenda të katër mureve të

shpisë mos me pa diell me sy! As një nanë nuk thotë se kam vajze të keqe, por pashà kryet e saj e ke të kequn, punëtore e të zojën me mbajte një shpi. I vjen për dore çdo punë dhe sa për punë granie gjylpanë, gjypner i qëndisë dora çka i sheh syni.

-Lulë burmesha, ta jap fjalën e burrit se ajo për të cilën ti druhesh, nuk ka me ndodhë, por po shtoj edhe një tjetër: Nata e Shën Kollit në shpinë e Mehmet Mulosmanit ka me u festue për gjatë mot me ferlik e venë e raki si në Pecaj të Shalës.

ZHVILLIMI I IMAZHIT TË SHKODRËS EKONOMINË E TURIZMIT TË TIJ (PARE NGA TURISTËT)



Klodjuna Serraj

Shumë njerëz inte-resohen për mënyrën se si perceptohen nga të tjerët përreth tyre. Disa studime të fundit të fushës kanë vërtetuar se fenomene të tilla si shqetësimi i imazhit social apo opinionit kanë ndikim të fortë në një sërë sjelljesh përfshi këtu edhe sjelljet ekonomike. Kemi dëgjuar rëndom shprehjen se “Imazhi shet” një nga faktorët kyçë të sjelljeve ekonomike, e cila do të ketë më pas një ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit. Pra, ideja e këtij studimi në fund të tij do të jetë, se si ndikon imazhi i emrit të mirë, vlerësimet, rivierës, diplomacia, marrëdhëniet ndërkombëtare në rritjet ekonomike të një vendi. Për 2017 mbërritjet totale të huaja ishin 5. 117. 700 turistë. Norma e rritjes mesatare vjetore për periudhën 2013-2017 është 12 %.

¹.Të ardhurat nga turistët e huaj në 2017 janë 1.5 miliardë ALL

².Një rritje e tillë e kërkesës turistike ndërkombëtare nënkupton një diversitet nevojash, kërkesash dhe dëshirash prej tyre.

Tashmë ashtu si dhe në industrinë e tjera, edhe në turizëm nuk mund të prodhohet gjithçka për këdo. Tregu turistik ndërkombëtar po bëhet gjithnjë e më kërkuar më urgjent, ndaj ofertës në vend. Nga ana tjetër edhe operatorët në Shqipëri kanë kuptuar nevojën e klientit për ta kënaqur atë.

Ekonomia e turizmit

Shqipëria si vend mesdhetar i ka të gjitha mundësitë që të renditet midis vendeve të tjera mesdhetare me turizëm të zhvilluar, mirëpo faktorë të ndryshëm ekonomik, shoqëror e politik e kanë penguar një zhvillim të tillë. I gjithë fluksit turistik varet nga periudha, se me cilat shtete kemi pasur marrëdhëniet më të mira. Ndërsa sot situata është pak ndryshe, ne kemi të gjithë kufijtë e hapur po përpiqemi të krijojmë marrëdhënie me çdo shtet

¹INSTAT (Turizmi në shifra 2018)


²Banka e Shqipërisë (Turizmi në shifra 2018)

edhe sjellja e turistëve është më ndryshe se në vitet e shkuara. Për realizimin e këtij artikulli është bërë kërkimi i të dhënave parësore, janë bërë intervista gjysëm të strukturuar, dhe observime me drejtues të agjensive të udhëtimit dhe specialiste të turizmit marketingut me qëllim nxjerrjen e termave të pyetësorëve si dhe për të vlerësuar profilin e turistëve të huaj që vijnë në Shkodër. Janë bërë me qëllim që të përshkruajnë turistët e huaj që vizitojnë Shkodrën mbi bazë të karakteristikave të tyre demografike, të sjelljes se tyre turistike në origjinë, vlerësojnë faktorët që turistët e huaj përdorin për të marrë vendimin për të zgjedhur Shqipërinë dhe Shkodrën si një destinacion, perceptimin e turistëve për Shqipërinë krahasuar me destinacionet e tjera në rajon, dhe situatën ekzistuese të shërbimeve.






Ekonomia e turizmit në zonën e Dukagjinit

Nga vëzhgimet e bëra në zonën e Dukagjinit është vënë re se kryesisht vetëm zona e Republikës Çeke dhe Polonisë kanë njohuri për zonën pasi e kalojnë atë kryesisht si një tur në Alpet Shqiptare por instancat përkatëse për zhvillimin e ekonomisë turistike nuk bëjnë akoma diçka konkrete për zonën ku i gjithë ambjenti mund të jetë vërtet një pikë e fortë në zhvillimin e zonës, si rrjedhojë në punësimin e banorëve të zonës në periudhën afat gjatë të saj. Duke parë gjithë natyrën që ofron Dukagjini dhe burimet natyrore të pranishme në çdo hapësirë dhe zonë të saj mund të jete një burim edhe në të ardhurat ekonomike në zhvillimin e turizmit.

Nga rezultati nxjerrim përfundimin se:



Nga sa shihet më lart pjesa më e madhe e turistëve, që vizitojnë Shkodrën dhe zonat rreth saj janë të gjinisë mashkullore, numri i vizitorëve është



i moshës 21-30 vjeç, ndërsa për sa i përket rezidencës janë mesë shumti nga Italia, Kosova, Polonia, Republika Çeke, por me përqindje shumë pak të ulëta, se vendet e para janë nga Gjermania SHBA-te dhe Anglia.

Nga grafiket më lart kuptojmë se turistët nga shkallët e vlerësimit nga 1 deri në 5 janë relativisht të kënaqur me mikëpritjen, e sigurisht kjo është një nga virtytet tona.

Për sa i përket informacionit për destinacionet kënaqësia, që ata marrin është e ulët informacioni që jepet për zonat turistike në Shkodër nuk është i lartë sidomos për zonat e malore ku në të vërtet tërheqja turistike dhe bukuria e maleve tona, do të ishte shumë e lartë, I vetmi vend që ata kishin informacion ishte Thethi, ndërsa për krahasim të tjera të Dukagjinit, informacioni i disponuar ishte pothuajse “0”, për sa i përket pamjes turistike. Çmimet i vlerësojnë si të ulëta, në mesatare sigurisht ky vlerësim është bërë në bazë të të ardhurave të tyre, jo të të ardhurave në Shqipëri çka e bën një variabël që mund të përdoret si një nga pikat më të forta për zhvillim. Për sa i përket vlerësimit dhe raportit cilësi / çmim, d.m.th. nëse ata e merrnin atë që paguanin ishte pothuajse neutral duke e lidhur edhe me shpenzimet ditore nga të intervistuarit vlera që janë shpenzuar nga secili prej tyre e marre kjo si shifër mesatare varion nga vlera 10 Euro, kryesisht nga turistët nga Kosova deri në vlerësim maksimale që varion në shifrën e 60 Euro nga turistët që vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia dhe Zvicra.

Lidhur me arsyet, që ata kanë vizituar Shkodrën janë:

- Sugjerim nga miqtë, ku prej tyre ishin shqiptar ose të tjerë, që kanë qenë më përpara;
- Bileta avioni të lira nga vendi i origjinës;
- Zgjedhje rastësor nga kërkimet në internet për Evropën Juglindore;
- Një turr në Mesdhe ose në Ballkan

Nga informacioni i marrë kemi kuptuar se: imazhi i Shqipërisë lidhet ngushta me situatën që Shqipëria politike ka pasur ndër vite duke ndikuar në karakterin e përgjithshëm, vendin e origjinës se turistit. Fjala e mire e përcjellë nga turistët ose miqtë, ka një ndikim shumë të madh në rritjen e vizitave. Duke e parë dhe nga studimi, ndikimi i fjalës dhe sugjerimin nga miqtë ishte një nga pikat kyçe për sjelljen e turistëve në vend.

Mundësoi Botimin:
Av. ALFRED ZEF BARI



REDAKSIA

Kryeredaktore: **Suela Ndoja**

Redaktorë: **Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.**